


UNIVERZITETI I EJL

ЈИЕ УНИВЕРЗИТЕТ

SEE UNIVERSITY



Fakulteti i Administratës Publike dhe Shkencave Politike

Факултет за јавна администрација и политички науки

Faculty of Public Administration and Politics Science

STUDIME PASDIPLOMIKE - CIKLI I DYTË

FAKULTETI: Administratë Publike dhe Shkenca Politike

DREJTIMI: Administratë Publike

TEZA:

Funksionimi i pushtetit lokal në komunën e Preshevës

**Mendimi i qytetarëve mbi shërbimet e pushtetit lokal në Komunën e
Preshevës**

KANDIDAT-JA:

Selvete Limani

MENTORI:

Prof.Dr.Agron Rustemi

Tetovë, maj 2018

DEKLARATË

Unë, Selvete Limani, me përgjegjësi të plotë deklaroj se jam autore origjinale e këtij disertacioni dhe puna e raportuar këtu ka përbërje tërësisht origjinale. Informacioni i marrë nga puna e botuar ose e pabotuar e të tjerëve është i cituar në tekst dhe referencat janë dhënë në listën e burimeve .

Tetovë, 2018

FALENDERIME

Ky punim është rezultat i një përpjekjeje të madhe personale. Ndhmësi im kryesor në këtë përpjekje për realizimin e kësaj teze ishte Prof. Dr. *Agron Rustemi*. Me durim dhe këmbëngulje më udhëhoqi gjatë realizimit të gjithë punës sime. Sugjerimet e tij, vërejtjet dhe mbështetja morale, ndikuan në përfundimin me sukses të këtij punimi. E konsideroj të vlefshme ta falënderoj nga zemra për ndihmën dhe mbështetjen e ofruar.

Së dyti, dua të falënderoj gjithë pedagogët e Fakultetit të Administratës Publike - UEJL që me vërejtjet dhe sugjerimet e bëra, ndikuan në përmasimin e cilësisë së këtij punimi. Në fund, dua të falënderoj me gjithë zemër familjen time për përkrahjen dhe ndihmën e madhe që ma kanë dhënë për përfundimin me sukses të studimeve.

Nga zemra të gjithëve: FALEMENDERIT!

ABSTRAKT

Ky punim mbi qeverisjen vendore në komunën e Preshevës ka për qëllim të shtjellojë disa koncepte bazë mbi roli e qeverisje vendore si dhe raportin e saj me qytetarët e kësaj komune dhe me qeverisjen qendrore sipas legjislacionit në fuqi, si dhe të vërë theksin mbi faktorët kryesorë që ndikojnë në konsolidimin e qeverisjes vendore në komunën e Preshevës, bazuar në sistemin në fuqi, me qëllim realizimin e parimeve të decentralizimit dhe ofrimit të shërbimeve në mënyrë sa më eficiente dhe në nivel sa më afër qytetarit. Duke qenë në dijeni se ky punim është modest për një temë të tillë që është mjaft e gjërë dhe komplekse dhe nuk mendojë se me këto radhë tu japë përgjigje shteruese problematikës së ngritur me anë të këtij punimi. Në këtë punim janë shtjelluar situata të caktuara ku qeverisja vendore mund të përmissohet dhe po ashtu janë pikasur edhe disa mangësi në zbatimin e politikave të qeverisjes, mangësi këto që kanë të bëjnë në masë të madhe me konsolidimin strukturor të funksioneve brenda vetë sistemit aktual të qeverisjes vendore. Gjithashtu ky punim ka për qëllim të vërë në pah gjendjen aktuale të qeverisjes vendore në raport me qytetarët, ku si metodë kam përdorur anketimin me qytetarët, se sa ata janë të kënaqur me funksionimin e pushtetit lokal, si dhe të vërë theksin në disa faktorë që ndikojnë në qeverisje që ajo të jetë sa më efikase për të gjithë qytetarët.

ABSTRACT

This paper on local governance in the municipality of Presevo aims to elaborate some basic concepts on the role of local government and its relationship with citizens of this municipality and central government according to the legislation in force, and to emphasize the main factors that affect the consolidation of local government in the municipality of Presevo, based on the system in force, in order to achieve decentralization principles and service delivery in the most efficient and close way to the citizen. Knowing that this work is modest for such a topic that is quite broad and complex and does not think that with these lines give an exhaustive answer to the problem raised by this paper. In this paper some specific situations are discussed where local government can be improved and also some shortcomings in the implementation of government policies are highlighted, the deficiencies that have to do with the structural consolidation of functions within the actual system of governance local. Also, this paper aims to highlight the current state of local government in relation to citizens, where as a method I used the survey with citizens, how satisfied they are with the functioning of local government, and emphasize some factors that influence governance to make it more effective for all citizens.

Përmbajtja

FALENDERIME.....	3
ABSTRAKT.....	4
SHKURTESAT	9
LËNDA E HULUMTIMIT	10
QËLLIMI I HULUMTIMIT	10
HIPOTEZAT	10
METODOLOGJIA E HULUMTIMIT	11
HYRJE	12
KAPITULLI I PARË	13
Aspektet Teorike të Pushtetit Lokal.....	13
1. Format e para dhe zhvillimi historik i qeverisjes lokale.....	13
2. Lindja dhe zhvillimi i vetëqeverisje lokale si disiplinë shkencore.....	15
3. Vetadministrimi lokal si subjekt juridik	17
4. Përkufizimi i pushtetit lokal.....	18
5. Karta Evropiane për vetadministrimin lokal.....	18
6. Përkufizimet teorike dhe normative	20
7. Misioni i pushtetit lokal	23
8. Decentralizimi	24
8.1 Decentralizimi Politik	25
8.2 Decentralizimi Administrativ	25
8.2.1 Dekoncentrimi	25
8.2.2 Delegimi	26
8.2.3 Devoluimi	26
8.3 Decentralizimi Fiskal	26
8.4 Decentralizimi Ekonomik dhe i Tregut.....	27
8.4.1 Privatizimi	27
8.4.2 Derregullimi	28
9. Zgjedhja e mënyrës më të përshtatshme për decentralizim	28
10. Racionale për Decentralizimin	30
11. Argumentet Ekonomike për Decentralizimin.....	31
12. Kushtet për decentralizim të suksesshëm.....	33
KAPITULLI I DYTË.....	34
Funksionimi i Pushtetit Lokal në Komunën e Preshevës.....	34

1. Historiku	34
2. Të dhënat demografike	36
3. Statuti i Komunës së Preshevës.....	40
3.1 Puna publike	42
3.2 Kompetencat e Komunës	42
3.3 Financimi i punëve të Komunës	44
3.4 Raportet e organeve të Republikës, autonomisë territoriale dhe i organeve të njësive të Vetad Ministrimit Lokal.....	45
3.5 Mënyrat nëpërmjet të cilave qytetarët mund të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në njësitë e Qeverisjes Lokale.....	47
3.5.1 Iniciativat qytetare	48
3.5.2 Referendumi	49
3.5.3 Tubimi	50
3.5.4 Diskutimet Publike	50
3.5.5 Anketimet	51
4. Shërbimet lokale që ofrohen nga Komuna e Preshevës(infrastruktura, arsimi, shëndetësia etj).	51
4.1 Shërbimet Publike të Ndërmarrjeve Publike.....	52
5. Problemet në disa fusha të caktuara në Komunën e Preshevës.....	52
5.1 Infrastruktura	52
5.2 Shëndetësia.....	53
5.3 Bujqësia.....	54
5.4 Edukimi dhe Kultura.....	55
5.5 Ekonomia	57
6. Transparenca në funksionimin e pushtetit lokal në Preshevë	58
7. Donacionet nga OJQ- ët (UNDP, USAID)	61
7.1 Donacionet nga USAID dhe UNDP në Komunën e Preshevës.....	64
KAPITULLI I TRETË.....	65
Hulumtim empirik mbi mendimin e qytetarëve për pushtetin lokal në Komunën e Preshevës.....	65
Lista e Grafikoneve	
Grafikoni 1.....	65
Grafikoni 2.....	66
Grafikoni 3.....	66

Grafikoni 4.....	67
Grafikoni 5.....	67
Grafikoni 6.....	68
Grafikoni 7.....	68
Grafikoni 8.....	69
Grafikoni 9.....	70
Grafikoni 10.....	70
Grafikoni 11.....	71
Grafikoni 12.....	71
Grafikoni 13.....	72
Grafikoni 14.....	72
Grafikoni 15.....	73
Grafikoni 16.....	73
Grafikoni 17.....	74
Grafikoni 18.....	75
Grafikoni 19.....	75
Grafikoni 20.....	76
Anketa.....	77
Pyetjet e Anketës.....	78
KONKLUSIONE DHE REKOMANDIME	82
BIBLOGRAFIA.....	85
web-faqe.....	86

SHKURTESAT

PL – Pushteti Lokal

PQ- Pushteti Qendror

NP- Ndërmarrje Publike

OKB- Organizata e Kombeve të Bashkuara

BE- Bashkimi Evropian

USAID- Agjensia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar

UNDP- Programi i Zhvillimit të Kombeve të Bashkuara

LËNDA E HULUMTIMIT

- Temë aktuale;
- Është temë që e prek shoqërinë në përgjithësi . Duke qenë vet studente e administrimit publik dhe shkencave politike konkretisht studente e administrimit publik është mëse normale që hulumtimi im të jetë i kësaj natyre;
- Jam pjesë e kësaj komune dhe opinioni im është se: funksionimi jo i mirë i kësaj komune vjen si pasojë e mos ngritjes së zërit të qytetarëve të kësaj komune dhe pikërisht kjo hipotezë më shtiu që të ndalem në këtë tezë. Një analizë e mirëfillt e kësaj fushe është sot mëse e nevojshme duke shikuar se në çfarë gjendje jo stabile, të mjerueshme dhe me shumë vështirësi e shumë probleme qëndron popullata e kësaj komune.

QËLLIMI I HULUMTIMIT

Qëllimi i këtij punimi është hulumtimi më i thellë dhe i detajuar i pozitës së qytetarëve në këtë komunë në çështjen e shërbimeve të pushtetit lokal në komunën e Preshevës.

Hulumtimin do e pasurojmë me anketa dhe deklarata të ndryshme me qytetarët dhe të punësuarit në këtë komunë.

HIPOTEZAT

Hipoteza e parë:

Funksionimi i pushtetit lokal në komunën e Preshevës, funksionimi jo i duhur dhe në dëm të qytetarëve të kësaj komune.

Hipoteza e dytë:

Mendimi i qytetarëve mbi shërbimet e pushtetit lokal në komunën e Preshevës, mendim i cili nuk muret parasysh asnjëherë nga udhëheqësit e kësaj komune.

METODOLOGJIA E HULUMTIMIT

Gjatë këtij hulumtimi do të përdorim të dhëna nga burime parësore dhe dytësore që do të thotë nga libra të botuar, artikuj të ndryshëm , intervista , deklarata, etj

Në shërbim të hulumtimit do të ndjekë këto metoda:

- Metoda e analizës dhe sintezës-kjo metode do të përdoret për prezantim logjik të objektit të hulumtimit.
- Metoda e induksionit dhe deduksionit- kjo metodë do përdoret për të ardhur deri te konkluzionet dhe rekomandimet lidhur me tezën në fjalë.
- Metoda e anketimit - kjo metodë do të përdoret për anketim të palëve të përfshira që janë qytetarët e kësaj komune.

HJRJE

Trendi i zhvillimeve politike, ekonomike dhe shoqërore në botë, kohëve të fundit është duke rrjedhë në dy kahje të kundërta, në njërën anë drejt globalizimit dhe në anën tjetër drejt lokalizimit. Kjo lëvizje e gjithmbarshme e shoqërisë njerëzore ka ndikuar në masë të madhe edhe në ndryshimet e sistemeve të qeverisjes, në veçanti të qeverisjes lokale. Ndërtimi i koncepteve politike për mbrojtjen dhe afirmimin e të drejtave të njeriut, në veçanti krijimi i sistemeve konkurruese demokratike të ekonomisë së tregut në shërbim të rritjes së mirëqenies së qytetarëve të një vendi, ka krijuar parakushtet për zhvillime të hovshme të sistemeve politike dhe administrative në shërbim të qytetarëve. Secili vend në botë sot e ka pranuar decentralizimin si instrument politik demokratik për ta zbritur pushtetin e centralizuar të vendit sa më afër qytetarëve të vetë. Është një proces shumë i ndjeshëm, i ndërlikuar dhe nganjëherë i paqëndrueshëm, por që ka rezultuar i suksesshëm. Si pasojë e zhvillimeve politike në vend, Komuna e Preshevës ende nuk është integruar plotësisht në sistemin e vetëqeverisjes lokale, ndërsa pjesa më e madhe e shqiptarëve në këtë komunë janë të përfshirë në jetën politike të vendit. Por, sot korniza aktuale ligjore i ka dhënë një autonomi të plotë organeve të PL. Decentralizimi i pushtetit, reforma e pushtetit lokal duke fituar një shkallë të lartë të autonomisë në qeverisjen e komunave, ka ndikuar në integrimin e komuniteteve dhe krijimin e një politike stabile dhe të unifikuar në vend. Kështu sistemi i ka arritur objektivat kryesore: ***Krijimin e shtetit me një shoqëri të qëndrueshme multi-etnike, integrimin e komuniteteve në institucionet vetëqeverisëse të vendit dhe, ofrimin e shërbimeve cilësore për qytetarët.***

Pra qytetarët kanë të drejta të barabarta, që vetë t'i zgjedhin përfaqësuesit e tyre për t'i qeverisur dhe për t'i shërbyer atyre dhe po ashtu për t'i shkarkuar nëse nuk qeverisinë mirë me pasuritë e tyre. Kështu pushteti i vetëqeverisjes lokale buron vetëm nga vullneti i qytetarëve duke përjashtuar çdo mundësi të ndërhyrjes nga lartë, me përjashtim të gjykatave kompetente kur organet e PL e shkelin ligjin. Megjithatë, institucionet qendrore, pa mbështetje ligjore, kanë ndërtuar strukturë administrative ndërmjet PL dhe atij qendror duke dashtë që t'ju ofrojnë ndihmë PL në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore për qytetarët.

KAPITULLI I PARË

Aspektet Teorike të Pushtetit Lokal

1. Format e para dhe zhvillimi historik i qeverisjes lokale

Duke nisur nga përkufizimi i vetëqeverisjes lokale, sipas të cilit qytetarët kanë të drejtën e udhëheqjes së punëve publike me interes të përbashkët“, zanafillën e vetëqeverisjes lokale duhet ta kërkojmë qysh në historinë e hershme, në periudhën e organizimit të lagjeve të shtet-poliseve greke, ku qytetet paraqiteshin si „*tërësi të pavarura me rregullim të administratës nga ana e vetë banorëve, të cilët dhe i kryenin punët me interes për veten e tyre*“. Në shtet-qytetet greke janë themeluar kuvendi “*Agora*“, Këshilli i qytetit, Gjyqet dhe organet e tjera, ndërsa nxirreshin dhe norma juridike, me qëllim të rregullimit të marrëdhënieve shoqërore. Si shembull tipik merret Athina. Me zhvillimin e qyteteve, zhvillohen veprimtaritë prodhuese dhe tregtare dhe, në këtë mënyrë, krijohen marrëdhënie të reja shoqërore dhe lindin perandoritë, siç janë ato romake dhe Bizantine.

Si trajtë të vjetër të qeverisjes lokale, në Perandorinë Romake ndeshen „*komiiconet tribusione*“ të cilat merreshin me probleme lokale të popullatës në territorin e tribusëve (fshatrave dhe qyteteve) dhe ato zgjidhin organet e pushtetit (kuestorët dhe edilët). Tek më vonë, me zhvillimin e mëtejshëm të Perandorisë Romake, pas shekullit të II-të p.e.s. shfaqen komunat e *qytetit, municipet* dhe *kolonitë*. Kështu, çështjet që kishin të bënin me problemet brenda për brenda qytetit, zgjidheshin me municipe, kurse kolonitë kishin të drejtën , ndër të tjera, që edhe të emetonin paratë e veta të metalta. Perandoria Romake, kah fundi i saj, organizohet si dominat dhe përpos ndarjes në dy pjesë (lindje- perëndim), ndahet edhe në katër prefektura: *lindore, italike* dhe *galike*. Prefekturat ndaheshin në *dioçeza*, kurse dioçezat në *provinca*. Në krye të dioçezave ishin *viktarët*, kurse drejtuesit e provincave quheshin *rektoret*. Në këtë kohë, për herë të parë paraqitet institucioni i kontrollit të administratës komunale dhe asaj shtetërore. Krijimi i shërbimit të veçantë “*defensor civitas*“ evitonte mundësinë e keqpërdorimit të organeve shtetërore në kontrollimin e punës së komunave, si dhe evitimin e arbitrazimit të organeve komunle ndaj qytetarëve.

Shenjat e parat të qeverisjes lokale paraqiten në shekullin XII dhe XIII në disa shtete feudale të caktuara si në: Angli, Suedi, Zvicër, Gjermani, ku kemi një formë më të organizuar të qyteteve, një zhvillim të hovshëm ekonomiko-kulturor, por edhe politiko-administrativ.

Është kjo periudha e përpjekjeve të qyteteve dhe komunave mesjetare për një liri të vetadministrimit dhe të drejtave komunale. Bartëse e këtyre ndryshimeve ishte klasa qytetare e re, e cila i hapi proceset e rëndësishme të zhvillimit, qofshin ato sociale, politike etj. Mirëpo, kjo klasë kishte nevojë për *“hapësirë më të madhe veprimi”*, prandaj kërkonte më shumë liri dhe të drejta dhe përpiqej *“të shkëputte sa më shumë të drejta”* nga monarku absolut dhe nga aristokracia feudale. Gradualisht, qytetet fitojnë më shumë autonomi dhe fillojnë të çlirohen nga eksploatimi ekonomik i feudalëve. Në këtë mënyrë u krijuan *“qytetet e lira”* dhe *“komunat e lira”*, me pozitë juridike, ekonomike dhe politike të veçanta në organizimin shoqëror feudal. Veçohen të drejtat e vetadministrimit të qyteteve dhe komunave për të krijuar organet e veta, për të ndërtuar sistemin juridik dhe për të krijuar gjykatat e veta.

Mirëpo, këto të drejta ndryshonin nga qyteti në qytet dhe, duke nisur nga kjo, qytetet dhe komunat ndahen në:

- *Qytetet si republika të pavarura*
- *Qytetet me autonomi të plotë*
- *Qytetet me autonomi të kufizuar*

Gjatë kësaj kohe paraqiten edhe statutet e parat të qyteteve. Vetadministrimi i qyteteve dhe komunave zhvillohet në trajtë të pushtetit. Në fakt, pas revolucioneve borgjeze të shekullit XVIII dhe XIX, qeverisja lokale e merr kuptimin bashkëkohorë.

Lëvizja qytetare u paraqit me kërkesën e masës për *“liri lokale”* dhe për vetadministrim për bashkësi lokale. Në Francë, si njësi të vetëqeverisjes lokale ishin: *komunat*, *departamentet* dhe *distriktet* (distriktet ndaheshin në kantone). Parisi kishte një organizmin tjetër; komuna përbëhej prej 48 seksioneve. Pas komunës së Parisit, në vitin 1792, ndeshim parime të reja të forcimit të vetëqeverisjes lokale, ndërsa kah fundi i shekullit XIX, duke u mbështetur në këto parime, krijohet vetëqeverisja lokale si formë e decentralizimit, siç është në ditët e sotshme. Kjo periudhë është karakteristike edhe për zhvillimin e vetëqeverisjes lokale në SHBA, ku ndikim të madh të organizimit të saj pati organizmi i vetëqeverisjes lokale në Angli.

Në SHBA, në të gjitha “*kolonitë*”, paraqiten organet udhëheqëse të fshatrave, qytezave dhe qyteteve si dhe rretheve. Te njësitë më të vogla të vetëqeverisjes lokale (fshatra, qyteza), paraqiten dhe organizohen mekanizma të pavarur të vetëqeverisjes lokale, si kuvende dhe tubime të qytetarëve.

Edhe në Angli, gjatë shekullit XIX-të, vetëqeverisja lokale përjeton reforma të mëdha. Për herë të parë paraqiten rregulla për organizimin e vetëqeverisjes lokale (1835, 1882, 1888) dhe si organe të pushtetit lokal caktohen themelohen këshillat e qytetit (si organe përfaqësuese të zgjedhura).

Në Londër vetëqeverisja lokale është e rregulluar me ligj të veçantë. Anglia ka sistemin e vetëqeverisjes lokale në tri shkallë. Si njësi të pushtetit lokal (lokal government) paraqiten: *counties* (qarqet), *districts* (rrethet), *parishes* (famullitë).

Vetëqeverisja lokale në Gjermani ka traditë të vjetër dhe trajtat e ndryshme të saj paraqiten qysh herët, por reformat më të rëndësishme fillojnë aty qysh prej Kushtetutës të Vajmarit (1919). Vetëqeverisja lokale në Gjermani është mjaft e organizuar dhe funksionon si sistem shumëshkallësh, në nivel të njërive federale dhe në nivel të komunave (*gemeinde*), të rretheve (*kreis*), të qyteteve të lira (*stadt*), kurse në Bavari në nivel të qarkut. Ky sistem i vetëqeverisjes lokale karakterizohet me një pushtet të fortë ekzekutiv dhe efikas.

Siç vërehet vetëqeverisja lokale përgjatë historisë vazhdimisht pëson ndryshime, si në aspektin e brendshëm (nacional), kah fundi I shekullit të XX-të, ashtu dhe në aspektin ndërkombëtar.

2. Lindja dhe zhvillimi i vetëqeverisje lokale si disiplinë shkencore

Qeverisja lokale si disiplinë shkencore shumë- disiplinuar paraqitet me shumë tipare të veçanta, që nga lindja dhe gjatë zhvillimit të saj. Lindja e qeverisjes lokale ndërlidhet me dukuritë e para të saj, pavarësisht se ajo si disiplinë shkencore paraqitet shumë vonë, kur merr tiparet e një discipline të pavarur nga disiplinat e tjera shkencore, në kuadër të së cilave studiohej më parë dhe nga të cilat u shkëput në kushte dhe rrethana të reja të zhvillimit dhe të diferencimit të shkencës. Fillimisht ajo u studiua në kuadër të shkencave politike dhe shkencave juridike.

Secila disiplinë shkencore si dhe çdo dukuri a fenomen shoqërorë, kushtëzohet, në parim, me lindjen dhe zhvillimin e vet nga rrethana të caktuara shoqërore. Në literaturë bëhet

fjalë për disa parakushte që duhet të përmbushen kur bëhet fjalë për lindjen e shkencave shoqërore. Nuk ka dyshim se parakusht themelor i lindjes së një disipline shkencore është vetë paraqitja e substratit të dukurisë shoqërore të caktuar të cilin, në fakt, ajo disipline shkencore, e studion. Kështu, bie fjala, para lindjes të së drejtës, nuk ka pasur mundësi që të lind shkenca juridike përgjithësisht. Njëjtë është dhe me qeverisjen lokale. Para shfaqjes së institucioneve të qeverisjes lokale dhe lindjes dhe krijimit të marrëdhënieve në to, nuk ka pasur mundësi për emancipimin e plotë të kësaj disipline shkencore. Qeverisja lokale ka mundur të shfaqet si disipline e veçantë shkencore vetëm atëherë kur substrati i saj shkencor ka arritur shkallë të caktuar të zhvillimit në shoqëri. Përmenden dhe disi parakushte të tjera që janë me rëndësi për lindjen dhe zhvillimin e një disipline të veçantë shkencore. Dihet se në fillimet e shkencës përgjithësisht, të gjitha shkencat pothuajse ishin një dhe me to merreshin të njëjtit njerëz. Zhvillimi i shkencave, në vartësi prej zhvillimit të marrëdhënieve shoqërore, ndikoi në diferencimet e para të studimit të fenomeneve shoqërore dhe, si pasojë, specializimin e njerëzve për studimin e dukurive të caktuara dhe të fushave të caktuara të cilave u përkisnin ato dukuri.

Natyrisht se ndër elementet e tjerë kanë pasur ndikim dhe instrumentet e studimit të dukurive shoqërore, po sikurse dhe teknika e kërkimeve a hulumtimeve që janë zhvilluar dhe përsosur vazhdimisht. Më në fund, zhvillimi i një disipline shkencore është varur dhe nga rëndësia shoqërore që ka pasur ajo, varësisht nga aktualiteti i problematikës me të cilën është marrë dhe peshën që ka krijuar ajo për një bashkësi shoqërore të organizuar, në kohë dhe hapësirë të caktuar.

Mbi lindjen e vërtetë të qeverisje lokale si disipline më vete shkencore mund të bëhet fjalë vetëm atëherë kur në vendet e caktuara të botës shfaqen përpjekjet e ndërtimit të sistemit të veçantë të normave që rregullonin qeverisjen lokale dhe përmasat e shprehjes së saj. Që në fillim u vërejt nevoja që qeverisja lokale të trajtohet ndaras prej dukurive të tjera shoqërore dhe politike, edhe pse një kohë relativisht të gjatë të historisë së lindjes dhe zhvillimit të saj pati lëkundje në kuadër të cilave disiplina shoqërore përgjithësisht, juridike a politike veçanërisht, duhet të vendoset objekt i veçantë i studimit të qeverisje lokale.¹

¹ Aliu A. & Stavileci E. ;Qeverisja Lokale, njoftime themelore dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë – Prishtinë, 2009, f. 44.

3. Vetadministrimi lokal si subjekt juridik

Vetëqeverisja lokale paraqet një çështje mjaft të ndërlikuar si nga aspekti i shkencës politike edhe nga aspekti i praktikës politike kushtetuese. Në shkencat shoqërore, veçmas ato juridike e politike ka qasje të ndryshme lidhur me përmbajtjen e kuptimit të kësaj dukurie.² Njësitë e vetadministrimit lokal disponojnë me pronë dhe mjetet për realizimin e të drejtave dhe obligimeve. Për secilën komunë me kushtetutë dhe statutin e komunës i njihet cilësia e personit juridik.³ Si person juridik, komuna është subjekt i së drejtës dhe ka aftësi veprimi respektivisht mund të jetë bartëse e të drejtave dhe obligimeve. Si subjekt juridik komuna paraqitet në mbrojtje të interesit komunal dhe interesave të qytetarëve. Në të gjitha punët pronësore juridike, komuna paraqitet si subjekt juridik dhe atë e përfaqëson Kryetari i komunës ose përfaqësues i autorizuar nga ai në kryerjen e punëve juridike ose lidhjen e kontratave. Vetadministrimi lokal është e drejtë e qytetarëve në organizimi në nivel lokal me qëllim të drejtimit, vendosjes së punëve lokale dhe kjo paraqet një ndër të drejtat themelore demokratike të shoqërisë moderne.

Pa dallim nga organet qendrore të pushtetit, organet lokale merren me punët lokale dhe ata janë nën mbikëqyrjen më të ulët ose më të lartë të organeve qendrore. Për ta realizuar vetadministrimin modern dhe efikas, qytetarët duhet të ju sigurohen të drejta të caktuara si: e drejta që në komuna drejtpërdrejtë ose me zgjedhjen e përfaqësuesve të zgjedhur Këshillave lokal, të vendosin për punët që janë të rëndësishme për jetën dhe zhvillimin e njësive së vetadministrimit lokal pa ndikimin e organeve qendrore, e drejta në vetorganizimin dhe formimin e organeve përfaqësuese lokale ndaj të cilave ka kontroll dhe mjete për ndikim; vetadministrimi lokal ka pavarësi në nxjerrjen e akteve normative, pavarësia e njësive të vetadministrimit lokal ka pavarësi në kryerjen e punëve lokale dhe punëve të cilat ua ka bartë organi qendror, vetadministrimi lokal duhet vet të disponojë me mjete financiare që i takojnë. Nga kjo që përmenda pak më lartë mund të konstatojmë se, vetadministrimi lokal është formë politike e organizimit të qytetarëve në njësi administrative – politike. Njësitë e vetadministrimit në realizimin e kompetencave të veta ushtrojnë tri loje të punëve; kompetenca burimore, kompetenca të përbashkëta me pushtetin qendror dhe kompetenca të deleguara.⁴

²Saliu K.; E drejta Kushtetuese I, botimi III, Tetovë, 2002, f. 257

⁴Zendeli F.; E drejta administrative, Shkup, 2014, f. 121.

4. Përkufizimi i pushtetit lokal

Sa i përket përkufizimit të vetëqeverisjes lokale, si në aspektin teorik ashtu edhe në aspektin praktik, në varësi nga kushtet jo të njëjta të krijimit dhe të zhvillimit të saj, përdoren terminologji të ndryshme. Në gjuhën shqipe përdoren nocionet: *vetëqeverisje lokale*, *vetëqeverisje vendore*, *vetadministrim lokal* etj. Në gjuhën angleze përdoret termi *Local selfgovernment* (vetëqeverisje lokale). Shtetet anglosaksone në teori dhe praktikë nuk e kanë të zhvilluar këtë term, por e kanë përdorur termin *Local government* (qeverisje lokale). Në Gjermani përdoret termi *selbstverwaltung* (vetëqeverisje). Në Zvicër përdoret shprehja *administration locale* (vetadministrim lokal), ndërsa në disa kantone përdoret shprehja *komunal selbsverwaltung* (demokraci komunale). Në Francë përdoret termi *l'autonomi locale* (vetadministrim lokal). Në Itali *amministrazione locale* (vetadministrim lokal). Në Suedi *komunal forvaltning*. Në Spanjë *administracion communal*. Edhe në SHBA përdoret shprehja *localgovernment*. Në ish- Bashkimin Sovjetik është përdorur termi- *lokalni (mesni) organi na drzavna vlast*, i njëjti term përdorej edhe në shumë shtete të Evropës Lindore, ndërsa sot përdoret termi “*lokalna samouprava*”.⁵

5. Karta Evropiane për vetadministrimin lokal

U aprovua nga Këshilli i Evropës më 15.10.1985 dhe hyri në fuqi më shtator 1988, përcaktoi standardet e përbashkëta evropiane të pushteteve lokale. Karta evropiane përmban minimumin e obligimeve që çdo shtet duhet të parasheh në legjislacionin e vet. Kuptimi i rëndësisë që Këshilli i Evropës i kushtoi Konventës Evropiane është se ajo formoi organizatën e veçantë, respektivisht Kongresin e pushteteve lokale dhe rajonale në Evropë. Qëllimi i Këshillit të Evropës është që nëpërmjet të Kartës Evropiane për vetadministrim lokal, të ndikojë në legjislacionet e shteteve evropiane që të krijojnë model të njëjtë, standard të njëjta të vetadministrimit lokal, në frymën e demokratizimit dhe decentralizimit të pushtetit dhe të ndërtimit të një Evrope demokratike. Një ndër parimet demokratike bazë të Kartës Evropiane për vetadministrim lokal, është pjesëmarrja e qytetarëve në udhëheqjen e punëve publike (neni 4), si indikator për karakterin demokratik të sistemit politik të çdo shteti veçmas. Në Kartën Evropiane veçanërisht potencohet se “ruajtja dhe forcimi i rëndësishëm

⁵Zendeli F.; E drejta administrative, Shkup, 2014, f. 120

në ndërtimin e një Evrope të bazuar në parimet e demokracisë dhe decentralizimit të pushtetit”.

Koncepti i vetadministrimit lokal sipas Konventës Evropiane, realizohet nëpërmjet zgjedhjeve të lira dhe demokratike dhe nga krijimi i organeve të zgjedhura demokratike që do të kenë aftësi dhe autoritet që të sjellin vendime në përputhje me kompetencat që i kanë. Normat imperative që parasheh Konventa Evropiane paraqesin konceptin evropian të vetadministrimit lokal, me përmbajtjen si: koncepti kushtetues dhe ligjor i vetadministrimit lokal; e drejta e pushteteve lokale, që në kuadër të ligjit të zgjedhjeve të përgjithshme, me votë të fshehtë, të lirë dhe të barabartë; përcaktimi i kompetencave të vetadministrimit lokal me kushtetutë ose ligj, por edhe e drejta diskrecionale e pushteteve lokale që të vendosin për çështje të cilat nuk janë të parapara shprehimisht në ligj, të mbledhin dhe të disponojnë me mjete vetanake financiare, pastaj e drejta e bashkëpunimit të komunave brenda dhe jashtë shtetit, mbrojtja juridike e vetadministrimit lokal, mbikëqyrja administrative mbi organet lokale etj. Sipas Konventës Evropiane për vetadministrimit lokal shtetet nënshkruese të Konventës Evropiane për vetadministrimit lokal shtetet nënshkruese të Konventës marrim obligim që të respektojnë më së paku njëzet paragrafë nga pjesa e parë e Konventës. Por, në të njëjtën kohë, Konventa përmban elemente fleksibile duke mbajtur llogari për sistemet e ndryshme administrative në shtete të ndryshme. Organet e vetadministrimit lokal duhet të gëzojnë autonomi të plotë në realizimin e kompetencave burimore. Ata duhet të kenë kompetenca të plota dhe të qarta dhe shprehimisht të përcaktuara, duhet të eliminohet mbikëqyrja administrative dhe kufizimet në çështjet që kanë të bëjnë me shërbimet publike. Përparësitë e autonomisë së plotë të njësive të vetadministrimit lokal janë: subjektiviteti juridik, autonomia financiare, bashkëpunimi, kompetenca të gjëra burimore, mekanizma të kufizimit të ndikimit të organeve qendrore të pushtetit, autonomia politike, etj.

6. Përkufizimet teorike dhe normative

Pushteti lokal në sisteme të ndryshme dhe në vende të ndryshme me rregullim të ndryshëm shoqëror nuk ka pozitë dhe rëndësi të njëjtë që do të thotë se ekzistojnë dallime si në statutin ashtu edhe në shkallën e qeverisjes së njësive të pushtetit lokal të cilat vërehen qysh në përkufizimin e kuptimit të vetëqeverisjes lokale në terminologjisë që përdoret në gjuhë të ndryshme të botës, për të cilën u bë fjalë në pjesën më parë. Për përkufizimin e kuptimit të vetëqeverisjes lokale është evidentuar një mori përpjekjesh, por do të ndalemi vetëm në disa prej tyre. Sipas Redfield, vetëqeverisja lokale paraqet të arriturat e qytetarëve në kuadër të bashkësisë lokale ose përmes përfaqësuesit të tyre në funksione dhe autorizime të garantuara me ligj, ose në bazë të së drejtës së përgjithshme.

W. Robertson mendon se pushteti lokal paraqet ekzistimin e një bashkësie territoriale e cila i ka të parapara me ligj disa të drejta dhe nevoja për organizimin dhe rregullimin e punëve të veta. Vetëqeverisja lokale përcaktohet edhe si pushtet në bashkësinë lokale që gëzon shkallë të caktuar të lirive gjatë realizimit dhe zbatimit të të drejtave dhe obligimeve vetanake. Ai pushtet zbatohet në territore të kufizuar të shtetit nga ana e organeve që e përfaqësojnë vetëqeverisjen lokale.⁶

Ndërsa, sipas Jovan Gjorgjeviq ka katër sisteme kryesore të vetëqeverisjes lokale:

- *Vetëqeverisja lokale e bazuar në administrim nga ana e qytetarëve;*
- *Vetëqeverisje lokale e bazuar veçanërisht në sistemin dhe principet përfaqësuese të qeverisjes së kabineteve, respektivisht ndarjet e pushtetit;*
- *Vetëqeverisja lokale e bazuar në sistemin dhe principet e përfaqësuesve të qeverisjes presidenciale, komisioneve dhe menaxheriale;*
- *Vetëqeverisje lokale e bazuar në sistemin dhe principet përfaqësuese të qeverisjes së komiteteve ose kolegjiale ose edhe principeve të qeverisjes komunale.*

Ndërkaq, sipas sociologut slloven Z. Mllinar, komuna është bashkësi shoqërore lëvizëse e strukturuar dhe e përbërë nga banorët e një territori të caktuar në të cilën për shkak të plotësimit të nevojave materiale dhe të disa nevojave të tjera, zhvillohen aktivitete të

⁶Aliu A. & Stavileci E. ;Qeverisja Lokale, njoftime themelore dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë – Prishtinë, 2009, f. 30.

ndryshme etj. Ndërsa R. Lukiç e lidh vetëqeverisjen me një formë të caktuar të decentralizimit demokratik, si:

- *ekzistimi i organeve të decentralizuara të cilat i zgjedhin vetë banorët,*
- *kompetencat e pavarura të organeve të decentralizuara me të drejtën që organet më të larta të vlerësojnë vetëm ligjshmërinë.*

Ekzistojnë edhe shumë definicione të tjera lidhur me vetëqeverisjen lokale, kryesisht si rezultat i gjendjes ose pozitës të vetëqeverisjes lokale në vende të caktuara. Autorë të ndryshëm kanë ofruar shumë elemente në bazë të të cilave do të mundë të bëhej një përkufizim i qartë i qeverisjes vendore. Në lidhje me qeverisjen lokale janë me interes edhe njohuritë se.

- *Në secilin shtet bashkëkohor në të cilin ekziston qeverisja lokale është kategori e sistemit politik.*
- *Qenia e qeverisjes lokale kategori e sistemit politik vetvetiu nuk do të thotë se ajo ka secilin prej tyre pozitë dhe domethënie të njëjtë.*
- *Ekzistojnë dallime të rëndësishme në statutin dhe shkallën e vetëqeverisjes së njërive të vetëqeverisjes lokale në vendet të ndryshme të botës.*
- *Këto dallime shprehen edhe rreth kuptimit të vetëqeverisjes lokale.*
- *Organet lokale gëzojnë kompetencat e veta.*
- *Marrëdhëniet e institucioneve të qeverisjes lokale me pushtetin qendror karakterizohen me kontrollimin e tij të ligjshmërisë së punës së institucioneve lokale.*
- *Njësia e qeverisjes lokale disponon me mjetet e veta dhe të drejtën e destinimit të tyre.⁷*

Anderson thekson këto tipare të qeverisjes lokale: *territorin, popullatën, organizimin, identitetin juridik, autonominë, autorizimet, funksionet e qeverisjes dhe pavarësinë fiskale.* Ndërsa Peters tërheq vëmendjen në këto elemente të qeverisjes lokale: *detyrat e përbashkëta vetanake, administrimi i vetvetes, personi juridik, trupa të vetëzgjidhura, inkorporim me shtetin mbikëqyrjen e shtetit.⁸*

⁷ Aliu A. & Stavileci E. ;Qeverisja Lokale, njoftime themelore dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë – Prishtinë, 2009, f. 25.

⁸ Handbuch der Kommunalen wissenschaft und Praxis, Berlin, 1956, f. 47.

Si elemente të vetëqeverisjes lokale janë edhe këto:

- *Si formë politike e bashkësive lokale ajo pa dyshim është kategori e sistemit politik, ndërsa deri diku edhe e të drejtës kushtetuese.*
- *Ajo është shprehja e të drejtës së popullsisë në bashkësi të caktuara që pavarësisht të udhëheqin me punët të lidhura me locus-in.*
- *Ajo parimisht është institut demokratik, shumë me rëndësi për demokratizimin e sistemit politik.*
- *Ajo i dedikohet bashkësisë së caktuar sociologjike.*
- *Atë e karakterizojnë karakteristika të caktuara organizative pa të cilat nuk ka vetëqeverisje lokale:*
- *Popullsia e një territori të caktuar lokal vetë i zgjedh organet e veta të udhëheqjes;*
- *Popullsia direkt ose nëpërmjet organeve të tyre i kryen funksionet e pushtetit lokal dhe të gjitha funksionet e tjera të lidhura me bashkësitë lokale (kompetenca vendore);*
- *Organi përfaqësues ka kompetencën e vet të vërtetë, ku me realizimin e saj ndikon në jetën e bashkësisë;*
- *Organi përfaqësues zgjedh organet dhe institutet e veta;*
- *Vetëqeverisja lokale ka mbështetjen e vet materiale*
- *Marrëdhëniet e organeve më të larta dhe qendrore janë të themeluara me kushtetutë dhe me ligj. Ato së pari janë të krijuara për vlerësimin e ligjshmërisë së punës të organeve, ndërsa vetëm në pjesën e deleguar edhe vlerësimin e punës së përgjithshme.⁹*

Pikëpamjet e ndryshme që shpijnë në përkufizime të ndryshme të qeverisjes vendore, mund të përmbliidhen disa nga faktorët më dominantë më të përgjithësuar lokale.

- *Meqë parimet e qeverisjes lokale, përmbliidhen në aktet kushtetues, qeverisja lokale, padyshim kategori të së drejtës me kushtetuese.*
- *Qeverisja lokale nënkupton të drejtën e qytetarëve që në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe të mëvetësishme të vendosin çështjet me interes për njësinë e vet territoriale.*

⁹ Siljanovska – Davkova G.; "Komuna në mes normës dhe realitetit", Disertacion i mbrojtur në Fakultetin Juridik të Ljubljanes, 1993, 1993, f. .35, 36,37.

- *E drejta e qytetarëve shtrihet në zgjedhjen dhe kontrollin e institucioneve të veta lokale.*
- *Marrëdhëniet e institucionet të qeverisjes lokale me pushtetin qendror karakterizohen me kontrollin e tij në ligjshmërisë së institucioneve lokale.*
- *Njësia e qeverisjes lokale disponon me mjetet e veta dhe të drejtën e destinimi të tyre.*¹⁰

7. Misioni i pushtetit lokal

Në kuptim më të përgjithshëm, ai mision ka synim sigurimin e qeverisjes në një nivel sa më të afër qytetarëve. Misioni i pushtetit lokal shpërfaqet në forma të ndryshme, si respektim i të drejtave dhe lirive themelore të qytetarëve të sanksionuara në kushtetutë ose në ligj zgjedhja e llojeve të ndryshme të shërbimeve dhe lehtësirave të tjera publike lokale, ushtrimi efektiv i funksioneve, kompetencave dhe realizimin e detyrave nga organet e qeverisjes lokale, realizimin i shërbimeve në formën e përshtatshme, nxitja efektive e pjesëmarrjes së qytetarëve në qeverisjen lokale etj.

Sistemet bashkëkohore politike pretendojnë që ndarja e njësive territoriale e shtetit, gjegjësisht udhëheqja lokale, më shumë të përputhet me bashkësinë lokale si bashkësi reale në kuptimin social. Prandaj, zgjidhje ideale është atje ku është e mundur, vetëqeverisja lokale të përputhet me vendbanimin, me pjesët e vendbanimit gjegjësisht me disa vendbanime të lidhura si bashkësi reale. Në shoqëritë e zhvilluara vazhdimisht rritet numri i shërbimeve dhe organizatave profesionale të cilat kënaqin një numër më të madh të nevojave të banorëve në hapësirën lokale, të cilët dikur i kanë kryer me aktivitet personal. Shteti i "*tërësishëm*" mundohet që më shumë centralisht "*t'i kryejë*" problemet lokale dhe bashkësia lokale dhe vetëqeverisja lokale të jenë vetëm forma më të ulëta të ndarjes administrativo-territoriale të shtetit. Por, Evropa bashkëkohore mbrohet nga centralizimi me nxitjen e vetëqeverisjes lokale dhe decentralizimin.

Ndonëse vetëadministrimi lokal si formë e decentralizimit, paraqet një proces tepër kompleks dhe një nga çështjet sistimore të organizimit dhe funksionimit të pushtetit shtetërorë, ku proceset e reja demokratike zhvillohen mbi bazat e ndërtimit dhe pluralist

¹⁰ Aliu A. & Stavileci E. ;Qeverisja Lokale, njoftime themelore dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë – Prishtinë, 2009., f. 26.

gjithnjë duke u bazuar në respektimin e të drejtave dhe lirive të njeriut, sundimin e ligjit dhe koncepti civil etj, ekskluzivisht ai ka vlerë të lartë për demokracinë ku decentralizimi në vetvete parimisht konsiston në përmbajtjen e demokratizimit të raporteve të ndryshme shoqërore.¹¹

Vetadministrimi lokal si një ndër format kryesore të decentralizimit gëzon një sërë autorizimesh të cilat më pak janë autorizime shtetërorë e më shumë autorizime dhe shërbime publike, gjë që nënkupton të drejtën e qytetarëve të një bashkësie të caktuar territorial që të qeverisin punët e bashkësisë së tyre, nëpërmjet organeve që i zgjedhin vetë, drejtpërdrejt apo indirekt (në mënyrë të tërthortë).¹²

Parimet themelore të pushtetit lokal – të decentralizuar janë:

- *Parimi i decentralizimit*
- *Parimi i autonomisë*
- *Parimet e pluralizmit politik*
- *Parimi i barazisë dhe pjesëmarrjes së qytetarëve në pushtetin lokal*
- *Parimi i bashkëpunimit ndërmjet organeve lokale dhe qendrore etj.*¹³

8. Decentralizimi

Decentralizimi është transferimi i autoritetit dhe përgjegjësisë për funksione publike nga pushteti qendror në organizata qeveritare vartëse apo pothuajse të pavarura ose në sektorin privat dhe mbulon një hapësirë të gjerë konceptesh. Çdo lloj decentralizimi – politik, administrative, fiskal apo i tregut – ka karakteristika, rrjedhime politike dhe kushte të ndryshme për sukses. Të gjithë këta faktorë duhet të konsiderohen me kujdes përpara se të vendoset nëse projekti apo programi duhet të mbështesë riorganizimin e sistemeve financiare, administrative dhe shpërndarja e shërbimeve. Diferencimi i llojeve të ndryshme të decentralizimit është i rëndësishëm pasi hedh dritë në dimensionet e shumta të tij në nevojën për koordinim, por nga ana tjetër këto koncepte mbivendosin njëra tjetrën. Decentralizimi politik, administrativ, fiskal dhe i tregut mund të shfaqen në forma dhe kombinime të

¹¹ Osmani I.; Fillet e së Drejtës, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2004, f. 45.

¹² Berisha F.; Studime Juridike-I, Tiranë, 2004.

¹³ Berisha F.; Studime Juridike-I, Tiranë, 2004, f. 148.

ndryshme në vende të ndryshme, brenda vendit dhe madje edhe brenda sektorëve. Përkufizimet e sakta janë më pak të rëndësishme sesa përcaktimi i një modeli të kuptueshëm.

8.1 Decentralizimi Politik

Decentralizimi politik synon t'u japë qytetarëve dhe përfaqësuesve të zgjedhur të tyre më shumë pushtet në procesin e marrjes së vendimeve publike. Ky lloj decentralizimi shpesh është i shoqëruar me politika pluraliste dhe qeveri përfaqësuesve të tyre më tepër influencë në formulimin dhe zbatimin e politikave. Mbrojtësit e decentralizimit politik pretendojnë se vendimet e bëra me një pjesëmarrje më të gjerë do të jenë më mirë të informuara dhe më të fokusuara në interesat e shoqërisë, sesa ato të bëra nga autoritetet politike kombëtare. Ky koncept nënkupton se zgjedhja e përfaqësuesve nga juridiksionet elektorale u jep mundësi zyrtarëve të zgjedhur të njohin më mirë nevojat dhe dëshirat e zgjedhësve të tyre. Decentralizimi demokratik shpesh kërkon reforma kushtetuese, krijimin e partive politike pluraliste, forcimin e legjislacionit, krijimin e njësive lokale politike dhe inkurajimin e grupeve efektive publike.

8.2 Decentralizimi Administrativ

Decentralizimi administrativ kërkon të rishpërndajë autoritetin, përgjegjësinë dhe burimet financiare për sigurimin e shërbimeve publike ndërmjet niveleve të ndryshme të qeverisjes. Ai është transferimi i përgjegjësisë për planifikimin, financimin dhe menaxhimin e funksioneve të caktuara publike, nga pushteti qendror dhe agjencitë e tij tek njësitë në terren, të agjencive qeveritare, njësive vartëse, autoriteteve publike apo korporatave gjysmë-autonome ose autoriteteve rajonale. Decentralizimi administrativ ka tre forma kryesore – *dekoncentrimin*, *delegimin* dhe *devoluimin* – secila me karakteristika të ndryshme.

8.2.1 Dekoncentrimi

Dekoncentrimi, rishpërndarja e autoritetit vendimmarrës dhe përgjegjësiwe financiare dhe menaxhuese ndërmjet niveleve të ndryshme të pushtetit qendror, shpesh është konsideruar forma më e dobët e decentralizimit dhe përdoret më shpesh në shtetet unitare. Sidoqoftë, politikat dhe mundësitë për marrjen e inputit lokal ndryshojnë brenda kësaj kategorie: dekoncentrimi mund të zhvendosë përgjegjësitë nga zyrtarët e pushtetit qendror në kryeqytete tek ata që punojnë në rajone, provinca apo distrikte, ose ai mund të krijojë nja

administratë të fortë në terren apo kapacitetet administrativ lokal nën mbikëqyrjen e ministrive të pushtetit qendror.

8.2.2 Delegimi

Delegimi është një formë më e përhapur e decentralizimit. Nëpërmjet delegimit, pushtetet qendrore transferojnë përgjegjësitë e marrjes së vendimeve dhe administrimin e funksioneve publike, tek administrata gjysmë-autonome jo plotësisht të kontrolluara nga pushteti qendror por përgjegjës përpara tij. Qeveritë i delegojnë përgjegjësitë, atëherë kur krijojnë ndërmarrje publike apo korporata, autoritete vendase, autoritete të transportit, distrikte të shërbimeve të veçanta, distriktet e shkollave gjysmë-autonome, korporata rajonale të zhvillimit ose njësi speciale të zbatimit të projekteve. Zakonisht, këto organizata kanë shumë liri veprimi në marrjen e vendimeve. Atom und të përjashtohen nga detyrimet mbi personelin e rregullt të shërbimeve civile dhe mund të vendosin taksa të drejtpërdrejta për shërbimet tek përdoruesit.

8.2.3 Devoluimi

Devaluimi është transferimi i autoritetit për marrjen e vendimeve, financimin dhe menaxhimin tek njësitë gjysmë-autonome të pushtetit lokal me status korporate. Devoluimi zakonisht transferon përgjegjësitë për shërbimet, tek bashkitë që kujdesen vetë për zgjedhjen e kryetarit dhe anëtarëve të këshillit të rrethit, sigurojnë të ardhurat e tyre dhe kanë autoritet të pavarur për të marrë vendime për investimet. Në një sistem të devoluar, pushtetet lokale kanë njohur qartë dhe ligjërisht kufijtë gjeografikë mbi të cilët ato ushtrojnë autoritet dhe brenda të cilave ato realizojnë funksione publike. Është ky lloj I decentralizimit administrative, që vendos bazat e pjesës më të madhe të decentralizimit politik.

8.3 Decentralizimi Fiskal

Përgjegjësia financiare është një komponent kyç I decentralizimit. Nëse pushtetet lokale dhe organizatat private kryejnë me efektivitet funksione të decentralizuara, ato duhet të kenë të ardhura të mjaftueshme – të realizuara lokalisht ose të transferuara nga pushteti qendror – si dhe autoritet për të marrë vendime për shpenzimet. Decentralizmi fiskal mund të marrë shumë forma, që përfshijnë:

- *Vetë-financim apo mbulim të kostove nëpërmjet të ardhurave nga përdoruesit;*
- *Bashkë-financim apo bashkë-prodhim, në të cilin përdoruesit marrin pjesë në sigurimin e shërbimeve dhe infrastrukturës nëpërmjet kontributeve monetare dhe punës;*
- *Rritja e të ardhurave lokale nëpërmjet taksave mbi pasurinë apo nga shitjet ose të ardhurat indirekte;*
- *Transferta ndërqeveritare të të ardhurave të përgjithshme nga taksat e mbledhura nga pushteti qendror tek pushteti lokal, për përdorim të përgjithshëm apo specifik;*
- *Autorizim i marrjes hua nga bashkitë dhe mobilizim i burimeve kombëtare dhe të pushteteve lokale nëpërmjet garancive të huave.*

Në shumë vende në zhvillim, pushtetet lokale apo njësitë administrative kanë autoritetin ligjor të vendosin taksa, por baza e taksës është kaq e dobët dhe varësia tek subvencionet e pushtetit qendror është kaq e përcaktuar, saqë nuk bëhet asnjë përpjekje për të ushtruar këtë autoritet.

8.4 Decentralizimi Ekonomik dhe i Tregut

Format më të plota të decentralizimit nga perspektiva e një qeverie janë privatizimi dhe derregullimi; këto e zhvendosin përgjegjësinë e funksioneve nga sektori publik në atë privat. Ato lejojnë që funksionet që më parë kanë qenë ekskluzivisht përgjegjësi të pushtetit qendror, të realizohen nga bizneset, grupet e komunitetit, kooperativat, shoqatat vullnetarë private dhe organizata të tjera jo-qeveritare. Privatizimi dhe derregullimi zakonisht janë të shoqëruara me politika të liberalizmit ekonomik dhe zhvillimit të tregut.

8.4.1 Privatizimi

Privatizimi mund të variojë në qëllim nga siguri i të mirave dhe shërbimeve të bazuara plotësisht në veprimtarinë e lirë të tregut, të marrëdhëniet privato-publike në të cilat qeveritë dhe sektori privat bashkëpunojnë për të siguruar shërbimet apo infrastrukturën. Privatizimi mund të nënkuptojë lejimin e ndërmarrjeve private për të realizuar funksione që më parë kanë qenë të monopolizuara nga qeveria. Privatizimi do të thotë caktimi i ndërmarrjeve tregtare për sigurimin apo menaxhimin e shërbimeve publike. Ka një numër të madhe formash dhe mënyrash institucionale private-publike me të cilat organizohen funksione të tilla veçanërisht në infrastrukturë. Gjithashtu, privatizimi mund të përfshijë

financimin e programeve të sektorit publik nëpërmjet tregut të kapitaleve, me akte nënligjore apo masa të përshtatshme, për t'u siguruar se pushteti qendror nuk merr përsipër riskun për këtë marrje hua dhe për të lejuar pjesëmarrjen e organizatave private. Në përfundim, privatizimi mund të nënkuptojë transferimin e përgjegjësisë për sigurimin e shërbimeve nga sektori publik në atë privat, nëpërmjet privatizimit së ndërmarrjeve shtetërore.

8.4.2 Derregullimi

Derregullimi zvogëlon detyrimet ligjore për pjesëmarrjen private në sigurimin e shërbimeve ose lejon konkurrencën ndërmjet ofruesve privatë për shërbime që më parë siguroheshin nga qeveria apo monopole ligjore. Në vitet e fundit, privatizimi dhe derregullimi janë bërë alternative tërheqëse për qeveritë në vendet në zhvillim. Pushtetet lokale janë bërë alternative tërheqëse për qeveritë në vendet në zhvillim. Pushtetet lokale janë duke privatizuar, nëpërmjet kalimit të sigurimit të shërbimeve apo administrimit të kontraktorë të tjerë.

9. Zgjedhja e mënyrës më të përshtatshme për decentralizim

Në kushte të përshtatshme, të gjitha këto forma të decentralizimit, mund të ndihmojnë në zgjerimin e pjesëmarrjes së publikut në veprimtaritë politike, ekonomike, decentralizmi ndihmon në lehtësimin e ngadalësisë në marrjen e vendimeve, që shkaktohet nga planifikimi i pushtetit qendror dhe kontrolli i veprimtarive të rëndësishme ekonomike dhe shoqërore. Decentralizimi mund të ndihmojë në thjeshtimin e procedurave kompleks burokratike dhe mund të ndihmojë në thjeshtimin e procedurave komplekse burokratike dhe mund të rrisë sensibilitetin e zyrtarëve qeveritarë ndaj nevojave dhe kushteve lokale. Për më tepër, decentralizimi mund të ndihmojë ministrinë e pushtetit qendror që të sigurojnë shërbime në një numër më të madh zonash lokale; lejojnë përfaqësi më të madhe politike të grupeve të ndryshme politike, etnike, besimtare dhe kulturore në marrjen e vendimeve dhe i lehtëson menaxherët kryesorë të ministrive qendrore nga detyrat rutine, duke u dhënë mundësi atyre të përqendrohen më tepër në politikë. Në disa vende, decentralizimi mund të krijojë një fokus gjeografik në nivel lokal, duke koordinuar më me efektivitet programet në nivel kombëtar, provincial, rajonal dhe lokal dhe mund të sigurojë mundësi më të mira për banorët lokalë që të marrin pjesë në procesin e marrjes së vendimeve. Decentralizimi mund të çojë në program

më krijuese, të reja dhe të përgjegjshme duke lejuar eksperimentimin lokal. Ai mund të rrisë stabilitetin politik dhe bashkimin kombëtar, duke lejuar qytetarët që të kontrollojnë më mirë programet publike në nivelin lokal. Por decentralizimi nuk është një kurë dhe ai i ka disa disavantazhe të rëndësishme. Decentralizimi jo gjithmonë është eficient, sidomos për shërbimet standarde, rutinë dhe të bazuara në rrjet. Ai mund të rezultojë në humbje të ekonomisë së shkallës dhe të kontrollit mbi burimet e pakta financiare, nga pushteti qendror. Kapaciteti i dobët teknik apo administrative në nivelet lokale, mund të rezultojë shërbime më pak efektive dhe eficiente në disa zona të vendit. Përgjegjësitë administrative mund të transferohen në nivelet lokale pa burimet e nevojshme financiare, duke bërë më të vështirë shpërndarjen apo sigurimin në masë të njëjtë të shërbimeve. Decentralizimi mund të bëjë më kompleks koordinimin e politikave kombëtare dhe mund të lejojë marrjen në dorë të funksioneve specifike nga elita lokale. Gjithashtu, mosbesimi midis sektorëve publikë dhe privatë mund të minojë bashkëpunimin në nivel lokal.

Planifikuesit e projekteve dhe programeve duhet të jenë të aftë të vlerësojnë fuqitë dhe dobësitë e organizatave publike dhe të sektorit privat, në realizimin e llojeve të ndryshme të funksioneve. Përpara se të zhvillojnë plane të detajuara për decentralizimin, ata duhet të vlerësojnë atë nivel më të ulët organizativ të qeverisë që është i aftë të kryejë funksione me eficiencë dhe efektivitet, si dhe format më të përshtatshme të privatizimit për ato funksione që nuk duhet të ofrohen nga qeveria. Edhe ata hartues programesh që nuk e shohin decentralizimin si motivin e tyre primar, duhet të analizojnë me kujdes llojet ekzistuese të decentralizimit në një vend, në mënyrë që të përshtatin planet politike me strukturat ekzistuese. Suksesi i decentralizimit varet nga trajnimi i përshtatshëm i zyrtarëve në nivel kombëtar dhe lokal, në administratat e decentralizuara. Asistenca teknike kërkohet shpesh për pushtetet lokale, ndërmarrjet private dhe grupet jo-qeveritare lokale në planifikimin, financimin dhe menaxhimi e funksioneve të decentralizuara.¹⁴

Centralizimi dhe decentralizimi nuk janë kushte *ose-ose*. Në pjesën më të madhe të vendeve, një bilanc i përshtatshëm i centralizimit dhe decentralizimit është thelbësor për funksionimin efektiv dhe eficient të qeverisë. Jo të gjitha funksionet mund apo duhet të financohen dhe menaxhohen në një formë të decentralizuar. Edhe kur pushtetet kombëtare decentralizojnë përgjegjësitë, ato shpesh marrin përsipër role të rëndësishme politike dhe mbikëqyrës. Ato duhet të krijojnë dhe ruajnë kushtet që i japin mundësi njësive lokale të

¹⁴<http://documents.worldbank.org/curated/en/356911468766815123/pdf/19683010albanian.pdf>

administrimit apo organizatave jo-qeveritare, të marrin përsipër më shumë përgjegjësi. Ministritë qendrore shpesh kanë fole kryesore në promovimin dhe mbështetjen e decentralizimit, duke zhvilluar politika dhe vendime të përshtatshme dhe efektive kombëtare për decentralizimin dhe duke forcuar kapacitetet lokale institucionale, për të marrë përsipër përgjegjësi për funksionet e reja.

10. Racionale për Decentralizimin

Pjesa më e madhe e proceseve të decentralizimit që kanë ndodhur në dekadën e fundit, ka qenë motivuar nga shqetësime politike. Për shembull, në Amerikën Latine decentralizimi ka qenë një pjesë e rëndësishme e procesit të demokratizimit pasi regjimet qendrore autokratike u zëvendësuan nga qeveritë e zgjedhura që operojnë sipas kushtetutës së re. Në Afrikë, shpërndarja e sistemeve politike shumëpartiake ka krijuar kërkesa për më shumë zë lokal në marrjen e vendimeve. Në disa vende, si në Etiopi, decentralizimi ka ardhur në përgjigje të presioneve nga grupet etnike dhe rajonale për më shumë kontroll dhe pjesëmarrje në procesin politik. Në raste ekstreme, decentralizimi paraqet një përpjekje të dëshpëruar për të mbajtur vendin të bashkuar, në përgjigje të këtyre presioneve duke u dhënë më tepër autonomi të gjitha lokaliteteve ose duke lejuar “federate asimetrike”. Një variacion mbi këtë temë, ka qenë decentralizimi si një produkt i luftërave të gjata civile, si në Mozambik apo Uganda, ku mundësitë e hapura politike në nivel lokal kanë lejuar një pjesëmarrje më të madhe nga të gjitha ish-fraksionet luftarake në qeverisjen e vendit. Ekonomitë në tranzicion të ish-shteteve socialiste kanë decentralizuar një masë të madhe, pas rënies së aparatit të vjetër të centralizuar. Në shumë vende, decentralizimi ka ndodhur thjesht në mungesë të ndonjë strukture alternative kuptimplotë qeverisjeje, për të siguruar shërbimet e pushteteve lokal.

Në disa raste (sidomos në Azinë Jugore), decentralizimi shfaqet i motivuar nga nevoja për të përmirësuar shpërndarjen e shërbimeve tek popullsia e gjerë si dhe nga njohja e kufizimeve nga administrata qendrore. Megjithatë në shumë raste decentralizimi duket të ndodhë pa shumë planifikim dhe hartim, ka një shumëllojshmëri çështjesh që luajnë rol në ndikimin e decentralizimit mbi eficiencën, barazinë dhe stabilitetin makroekonomik. Suksesi i decentralizimit është i lidhur ngushtë me aderimin në disa nga parimet e hartimit: financimi i ndjekur nga një përcaktim i qartë i funksioneve, marrje vendimesh e informuar, mbështetje e prioritetëve lokale dhe përgjegjshmëri. Për shkak se kushtet e vendit ndryshojnë shpesh në

mënyra komplekse dhe jo të qarta, politikat dhe instrumentet institucionale që krijojnë decentralizimin duhet të hartohen sipas kushteve specifike.¹⁵

11. Argumentet Ekonomike për Decentralizimin

Gjithnjë e më tepër literatura botërore po studion arsyet ekonomike bazë për decentralizim. Ekonomistët e justifikojnë decentralizimin mbi bazat e efeciencës shpërndarëse. Arsyeja e tyre bazë është se vendbanimet për shpenzimet publike që janë kryer nga një nivel qeverisjeje që është më afër dhe më përgjegjës ndaj një votuesi lokal, ka më shumë të ngjarë të reflektojë kërkesën për shërbimet lokale, sesa ato vendime të marra nga një pushtet qendror në distancë. Një arsye e dytë ekonomike për decentralizim është përmirësimi i “konkurrencës” së pushteteve dhe nxitja e novacioneve dhe kështu mundësia që pushtetet do të veprojnë në përgjigje të dëshirave të qytetarëve. Një tjetër përfitim potencial është se njerëzit janë më të gatshëm të paguajnë për shërbimet që i përgjigjen prioriteteve, sidomos nëse ta janë të përfshirë në procesin e marrjes së vendimeve për shpërndarjen e këtyre shërbimeve.

Një numër problemesh teorike dhe praktike komplikojnë faktin nëse decentralizimi është një strategji ekonomike e mirëpo e padëshirueshme. Në nivelin makroekonomik, një shqetësim i rëndësishëm ka qenë fakti se decentralizimi mund të bëjë të vështirë zbatimin e politikave stabilizuese, si dhe në krijimin e shpenzimeve publike dhe borxhit publik. Sidoqoftë, sistemet e decentralizuara mund të krijohen për të shmangur efektet destabilizuese dhe për të krijuar nxitës të saktë. Një pjesë e decentralizimit të viteve 80-të ishte një shmangie e inbalancave fiskale, nga pushtetet qendrore te pushtete lokale. Në kushte të tilla, nuk është e habitshme të shohësh një lidhje të fortë ndërmjet decentralizimit dhe inbalanceve fiskale në nivelet e ulëta. Një tjetër debat në nivel makro, evidencat për të cilën nuk janë konkluzive është nëse decentralizimi vonon apo jo rritjen ekonomike.

Shqetësimet për barazinë – ndërrjuridiksionale dhe nderpersonale – kanë qenë shumë të rëndësishme për debatin e decentralizimit. Disa juridiksione kanë më tepër burime se të tjerat, ndoshta për shkak të madhësisë apo vendndodhjes. Përveç kësaj, rrethanat historike (të tilla si aparteidi), mund të kenë krijuar diferenca lokale. Për këtë qëllim, mund të hartohet një

¹⁵<http://documents.worldbank.org/curated/en/356911468766815123/pdf/19683010albanian.pdf>

program fiskal ndërqeveritar për të zhvendosur burimet në zona me më pak avantazhe për t'u siguruar se të gjithë qytetarët gëzojnë një minimum shërbimesh, pavarësisht nga vendndodhja, apo marrin asistencë për të shpejtuar përmasimi e deficiteve të krijuar për shkak të vendndodhjes. Shpërndarja e granteve për programet e varfërisë në nivelet lokale, duhet të analizohet me sukses brenda kushteve të një vendi të veçantë, meqenëse mungesa e transparencës ose shpjegimi i paqartë për hartimin e transferave ndonjëherë rezultojnë në atë që zona më të pasura marrin më shumë burime se ato më të varfra.

Shpesh debatohet se pushtetet qendrore janë plotësisht përgjegjëse për sigurimin e barazisë ndërpersonale. Aty ku ekonomitë lokale janë më të hapura dhe shumë burime, sidomos burimet kryesore njerëzore, janë të lëvizshme duhet pritur një sukses i kufizuar nga programet shpërndarëse të përqendruara sipas juridiksioneve. Megjithatë, pushtetet lokale mund dhe luajnë rol shumë të rëndësishëm në zbatimin e programeve qendrore shpërndarëse dhe në përcaktimin e një numri taksash, shpenzimesh dhe skemash të transfertave ndërmjet lokalitetëve. Shërbimet specifike që duhen decentralizuar dhe lloji i decentralizimit që duhet ndjekur, varen nga ekonomitë e shkallës që ndikojnë efciencën teknike dhe shkallën e ndjekur, varen nga ekonomitë e shkallës që ndikojnë eficiencën teknike dhe shkallën e efekteve tejkaluese jashtë kufijve juridiksionalë. Këto çështje duhet të merren në konsideratë në hartimin e një sistemi të decentralizuar. Në praktikë, nuk është e nevojshme të decentralizohen të gjitha shërbimet në të njëjtën mënyrë dhe në të njëjtin nivel.¹⁶

Në një sens të rëndësishëm ekonomik, tregu është forma përfundimtare e decentralizimit, ku konsumatorët mund të blejnë një produkt cilësor nga zgjedhja e furnitorëve. Natyra e pjesës më të madhe të shërbimeve lokale publike, kufizon realizimin e plotë të këtij optionsi dhe krijon një rol qeveritar në sigurimin e këtyre shërbimeve, por ai nuk kërkon që sektori publik automatikisht të jetë përgjegjës për shpërndarjen e të gjitha shërbimeve. Aty ku është e mundur të strukturoret konkurrenca, si në shpërndarjen e një shërbimi apo në të drejtën për të shpërndarë këtë shërbim, të dhënat tregojnë se shërbimi do të kryhet më me eficiencë. Megjithëse e pazakonshme në praktikë, pushtetet lokale kanë konkurruar me sukses për të drejtën e sigurimit të disa shërbimeve lokale. Në një varg shërbimesh lokale publike në çdo vend të dhënë, një shumëllojshmëri zgjidhjesh nga dekoncentrimi tek konkurrenca apo privatizimi i menaxhuar kanë të ngjarë që të bashkë-ekzistojnë më sukses në të njëjtën kohë.

¹⁶<http://documents.worldbank.org/curated/en/356911468766815123/pdf/19683010albanian.pdf>

12. Kushtet për decentralizim të suksesshëm

Megjithëse politika është një forcë udhëheqëse që qëndron prapa decentralizimit në shumicën e vendeve, decentralizimi mund të jetë një prej atyre momenteve të bukura ku politikat e mira dhe ekonomitë e mira i shërbejnë të njëjtit qëllim final. Objektivat politike të përgjegjësisë dhe pjesëmarrjes në rritje të politikës në nivel lokal, mund të përputhet me objektivat ekonomike të vendimeve më të mira për përdorimin e burimeve dhe gatishmëri në rritje për të paguar për shërbimet lokale. Për një decentralizim të suksesshëm janë të rëndësishme të paktën pesë kushte:

- *Kuadri i decentralizimit duhet të lidhë financim lokal dhe autoritetin fiskal me përgjegjësitë dhe funksionet e sigurimit të shërbimeve të pushtetit lokal, kështu që politikanët lokalë mund të bëjnë diçka për premtimet e tyre dhe të mbajnë përgjegjësitë e vendimeve të marra;*
- *Komunitetet lokale duhet të informohen për kostot e shërbimeve dhe opsioneve shpërndarëse si dhe paketën e burimit dhe mënyrën nga vjen, kështu që vendimet që ata marrin do të jenë kuptimplote. Buxheti pjesëmarrës siç është përdorur në Porto Alegre, Brazil është një mënyrë për të krijuar këto kushte;*
- *Komunitetet kanë nevojë për një mekanizëm për të shprehur preferencat e tyre në një mënyrë të tillë që t'i lidhin me politikanët, kështu që do të ketë një nxitës të besueshëm për pjesëmarrjen e njerëzve;*
- *Duhet të ketë një sistem përgjegjshmëria të bazuar në informacionin publik dhe transparent, që u jep mundësi komuniteteve të vëzhgojnë me efektivitet performancën e pushteteve lokale dhe të reagojnë në mënyrë të përshtatshme ndaj kësaj performance. Si rezultat politikanët dhe zyrtarët lokalë kanë një nxitës për t'u ndjerë përgjegjës;*
- *Instrumentet e decentralizimit - kuadri ligjor dhe institucional, struktura e përgjegjësive për shpërndarjen e shërbimeve dhe sistemi fiskal ndërqeveritar – duhet të hartohen në mënyrë të tillë që të mbështesin objektivat politike¹⁷*

¹⁷<http://documents.worldbank.org/curated/en/356911468766815123/pdf/19683010albanian.pdf>

KAPITULLI I DYTË

Funksionimi i Pushtetit Lokal në Komunën e Preshevës

1. Historiku

Komuna është njësi e vetëqeverisjes lokale si bashkësi e banorëve në një territor të caktuar me ligj, e cila përmes organeve të saja, administratës si dhe veprimtarive të organizuara publike, mundëson kryerjen e kompetencave të përcaktuara me ligj. Njësi të vetëqeverisjes lokale janë komunat dhe komunat janë persona juridikë. Komuna ka territorin dhe emrin e vet të përcaktuar me ligj.¹⁸



(Fig 1. Objekti i Kuvendit të Komunës së Preshevës).

Komuna e Preshevës i takon Rrethit të Pčinjës dhe shtrihet në një territor prej 264 km², në afërsi ndodhet kufiri me Maqedoninë dhe korridori ndërkombëtar E-10 i cili lidh Beogradin – Shkupin – Selanikun – Athinën. Përveç bazës urbane e cila paraqet qendrën komunale, komuna përfshin edhe 35 vendbanime. Ekzistojnë dy histori lidhur me origjinën e

¹⁸ Zendeli F.; E drejta administrative, Shkup, 2014, f. 129.

emrit të këtij vendi. Sipas disave emri Preshevë përbehet prej dy fjalëve: presh – që do të thotë presh dhe eva që në latinisht do të thotë fushë, që i bie fushë për kultivimin e preshëve.

Të tjerët mendojnë se toponimi Preshevë rrjedh nga gjuha hungareze e që në shqip i bie manë i egër. Asnjëra prej këtyre pohimeve nuk është vërtetuar. Komuna e Preshevës shtrihet në kulmin (Kërrusën e Preshevës) e Lugnajës së Moravë- Vardarit, ku lidhen këto dy lugina të mëdha, të cilat për së gjati, në drejtim veri- jug, përshkojnë Siujdhesën Ballkanike. Udha e vjetër, në drejtim lindje-perëndim, kryqëzohet në Fushën e Preshevës. Pozita e Komunës në qendër të Siujdhesës Ballkanike dhe në Lugnajën e Moravë- Vardarit, përpos rëndësisë strategjike ka pasur edhe rëndësi të madhe ekonomike dhe kulturore. Kështu, qysh nga kohërat më të vjetra- antika dhe mesjeta, territori i kësaj Komune ishte i banuar dhe jeta në të kurrë nuk është ndërprerë. Këtë më së miri e dëshmojnë gjetjet e shumta arkeologjike dhe numri i madh i rrënojave të kështjellave iliro- shqiptare, më vonë të rindërtuara nga romakët.

Presheva për herë të parë përmendet më 1381. Ndërtimi i hekurudhës së parë (më 1888) edhe më shumë shtron rëndësinë e kësaj komune. Këtë rëndësi e rrit edhe ndërtimi i rrugës automobilistike paralele me hekurudhën (më 1963). Në vitin më 1979 Presheva lidhet me Gjilanin, me rrugë të asfaltuar, e cila shfrytëzon Qafën e Livadhit të Shehut dhe Muçibabën. Banorët e parë vendas në antikë, në këtë trevë, ishin të parët tanë-ilirët, përkatësisht fisi ilir-dardanët. Më vonë, për shkak të pushtimeve të njëpasnjëshme të popujve të ndryshëm, ndryshohet struktura etnike, por kurrë nuk zhduket rrënja iliro-shqiptare. Ajo në antikën e vonshme dhe në mesjetën e hershme, me siguri, ka ekzistuar, përkundër romanizimit të popullsisë iliro-shqiptare. Edhe gjatë periudhës bizantine dhe mesjetës serbe në territorin e Komunës së Preshevës, përkundër sllavizmit intensiv, etnikumi iliro-shqiptar vazhdon të ekzistojë deri në ditët tona. Pas ardhjes së turqve në trojet shqiptare është ndaluar procesi i sllavizmit të shqiptarëve, por ka filluar myslimanizmi i vrullshëm i tyre. Megjithatë në disa fshatra të Karadakut deri vonë është ruajtur feja katolike. Pas luftës serbo-turke (1876-1878) në territorin e Komunës së Preshevës vendoset një numër i shqiptarëve (muhaxhirëve) të ikur nga trevat e Vranjës dhe të Toplicës. Pas luftërave ballkanike, Luftës së Parë dhe të Dytë Botërore një pjesë e shqiptarëve të këtushëm, për shkak të trysnive politike, fetare dhe ekonomike, shpërngulet për në Turqi. Të dhënat historike dëshmojnë se territori i Komunës së Preshevës gjithmonë dhe pandërprerë gjeografikisht-historikisht dhe në pikëpamje kulturore ishte Kosovë. Edhe pas disa vjetëve të

krijimit të krahinës së Kosovës (më 1945) Karadaku (nëntë fshatra të tij) i takonin Kosovës. Para Luftës së Dytë Botërore Presheva ishte qendër e rrethit e në këtë kohë është qendër komunale.¹⁹

2. Të dhënat demografike



(Fig 2. Lugina e Preshevës)

Komuna e Preshevës është komunë në qarkun Pčinjë në jug të Serbisë. Selia e komunës është qyteti Preshevë. Komuna ka pozitë strategjike në trekëndëshin kufitar Serbi-Maqedoni-Kosovë. Regjistrimi i popullsisë i vitit 1981, të cilën e bëri enti për statistikë në territorin e tërë ish-Jugosllavisë, ishte i fundit i cili i solli të dhënat e sakta mbi numrin e banorëve në Serbi. Komuna e Preshevës ka pasur 33.948 banorë. Shumica, mbi 91,3 % (31.098), ishin Shqiptarë, 6,5 % (2.204) Serbë dhe mbi 1 % (333) Romë. Lugina e Preshevës ndodhet në pjesën verilindore të trungut gjeoetnik shqiptar dhe paraqet vazhdimësi të natyrshme të tij. Vazhdimësia me gjeohapësirën shqiptare në Kosovë dhe Maqedoni dallohet qartë si në kompleksin e kushteve fiziko-gjeografike, ashtu edhe në tërësinë e normave historike, sociale, ekonomike, demogjeografike etj. Me Anamoravën Jugore në perëndim

¹⁹https://sq.wikipedia.org/wiki/Komuna_e_Preshev%C3%ABs

kufizohet përmes Karadakut të Preshevës, në lindje shtrihet deri te Mali i Rujanit dhe Kozjakut, në veri kufizohet me Malësinë e Bujanocit, ndërsa në jug, përmes ujëndarësit të ulët (450 m) dhe lehtë të kalueshëm të Preshevës ajo komunikon me Fushën e Kumanovës. Lugina e Preshevës ka të gjitha veçoritë e “territorit të korridorit” meqenëse nëpër këtë trevë kalon korridori më i rëndësishëm natyror i Gadishullit Ballkanik përmes luginës së Moravës dhe të Vardarit. Ky korridor njihet ndryshe si “Boshti primar meridional ballkanik”. Këto veçori i japin kësaj hapësire attribute të posaçme gjeokomunikative dhe gjeostrategjike. Me një sipërfaqe prej 1249 km², Lugina e Preshevës përfshinë komunat e Preshevës, Bujanocit e Medvegjës, ku jetojnë rreth 100.000 banorë. Ka një bazë relativisht të mirë gjeografike dhe natyrore, të përshtatshme për një zhvillim të përsheptuar ekonomik dhe social të regjionit. Mirëpo edhe përkundër faktit të sipërpërmendur, Lugina e Preshevës vazhdon të mbetet një ndërregjionet më të pazhvilluara në Serbi dhe në tërë Gadishullin Ballkanik. Kjo ngecje dëshmohej përmes treguesve të shumtë demografikë, socialë, ekonomikë dhe mjedisor në bazë të të cilëve Lugina kategorizohet në hapësirat me prapambeturi të skajshme ekonomike dhe sociale. Kjo ngecje është manifestuar me zhvillimin e disa proceseve regressive demografike, sociale e gjeomjedisore siç janë emigrimi dhe shpopullimi intensiv në zonat kodrinore-malore, menaxhimi jo i qëndrueshëm i resurseve natyrore, devastimi dhe efektet negative gjeomjedisore, zhvillimi i paplanifikuar dhe transformimi i ngadalshëm social-ekonomik i vendbanimeve, etj.²⁰

Nga 35 vendbanime në këtë komunë gjashtë (në mesin e tyre edhe Presheva) ishin etnikisht të përziera, por Shqiptarët ishin shumicë në mbi 82 % prej tyre. Katër vendbanime ishin të banuara vetëm me popullatë serbe, ndërsa 25 me popullatë shqiptare. Para 4 dekadave, në shumë vendbanime kishte më tepër popullatë të përzier, ku serbët ishin me prejardhje kolonizuese, të instaluar nga koha e pushtimit të Kosovës dhe Maqedonisë në vitin 1912 dhe veçanërisht pas konstituimit të Mbretërisë Serbo-Kroato-Slllovene, me vendimin e Konferencës së Versajës (1919). Lugina ishte dhe mbeti rajoni më i pazhvilluar në Serbi dhe në Ballkan: pjesët e banuara me shqiptarë sot janë më se 7 herë më të pazhvilluara se mesatarja e Serbisë. Shqiptarët e atjeshëm deri vonë ekskluzivisht jetonin nga bujqësia ekstensive dhe natyrale dhe brenda saj nga kultivimi i duhanit, ndërsa sot kryesisht jetojnë nga remitancat që i sjellin emigrantët e punës nga ky territor në vendet e Evropës dhe jashtë saj; rreth 60% të mjeteve të fituara u dërgojnë familjarëve në vendlindje për plotësimin e

²⁰ Pavlović M. Šabić D.; Regionalni pristup i tipovi regionalne diferenciacije teritorije, Zbornik Radova, Geografski Institut “Jovan Cvijić”, SANU, Beograd, 2006, f. 206.

nevojave elementare jetësore dhe pjesa tjetër për nevoja të tjera (shërimi, shkollimi i fëmijëve, ndërtimi i shtëpive, martesat etj.). Territori i komunave të Preshevës, Bujanocit dhe Medvegjës bën pjesë në tërësitë e mëdha etnogeografike ku përfshihen edhe rajonet e Gallapit dhe të Karadakut, e bashkë me to të tërë Kosovës, të lidhura pashkëputshëm me Luginën e Kumanovës-Shkupit dhe zonën e Karadakut, që sot pjesa më e madhe shtrihet në Maqedoni. Është evident fakti se numri i shqiptarëve në mënyrë dramatike po zvogëlohet, veçanërisht në komunën e Medvegjës, ku popullata shqiptare dikur përbënte një të tretën ose një të katërtën në numrin e përgjithshëm të popullsisë, ndërkaq sot ky numër mund të jetë vetëm simbolik, pasi të gjitha vërtetimet flasin se sa shumë është holluar komponenti demografik sa që nuk kanë mbetur më shumë se disa qindra shqiptarë. Shqyrtimi i kompleksit demografik, veçoritë, gjendja dhe proceset transformuese të zhvillimit të popullsisë dhe të vendbanimeve shqiptare në Luginë, trajtimi i zhvillimit ekonomik dhe i trashëgimisë kulturore, si dhe i përparësive të Luginës në bashkëpunimin ndërkufitar gjithnjë mund të shërbejnë si burim informacioni për rrjedhat demografike, për problemet dhe perspektivën e vendbanimeve dhe zhvillimin e përgjithshëm shoqëror.

Popullata shqiptare e Luginës, sikundër e gjithë hapësirës etnike shqiptare, paraqet tranzicionin e fundit demografik në Evropë dhe specificiteti i gjendjes demografike këtu deri vonë përshkohej para së gjithash nga normat e larta të komponentëve vitalë, ku baraspesha demografike midis lindjes dhe shuarjes së jetës arrihej me humbje të mëdha njerëzish, sikundër që ishte mjaft e theksuar autarkia demografike, me përqindje shumë të lartë të popullsisë imobile (autoktone), e lidhur për suaza familjare, vend të lindjes dhe bashkësi lokale, por të pavolitshme ishin edhe strukturat bazë socio-demografike (sipas moshës, gjinisë, arsimit, aktivitetit ekonomik dhe strukturës sociale etj.). Edhe në rastin e Luginës të dhënat zyrtare të vetë burimeve serbe me faktin shkencërisht të pranuar në shqyrtimet teorike dhe empirike se lindshmëria nuk është as etnikisht e as konfesionalisht e determinuar, por është rrjedhojë e proceseve komplekse zhvillimore shoqërore-ekonomike në kuptim të gjerë.

Niveli i lartë dhe rënia e ngadalshme e normave të variabëlve demografike të zëna në gojë dhe procesi i vonuar i tranzicionit demografik në përgjithësi në të gjitha trojet etnike shqiptare lidhen me dominimin e deridjeshëm të strukturës rurale, të tipit agrar të ekonomisë dhe izolimit social e hapësinor, shkallës shumë të ulët të shkrim-leximit e të arsimit, veçanërisht të femrave, pastaj me normat shumë të larta të mortalitetit të foshnjave e të fëmijëve të vegjël, me funksionimin specifik të familjes e të ekonomisë shtëpiake në kuadër

të së cilave kryheshin shumë funksione, para së gjithash funksioni biologjik dhe ekonomik, me nevojën dhe vetëdijen për numër më të madh të lindjeve si domosdoshmëri në ekonominë e karakterit natyral dhe për kontinuitetin familjar dhe social.

Në anën tjetër, këto vitet e fundit, për shkak të moszhvillimit ekonomik, të paramenduar e të qëllimshëm të regjimit serb dhe presioneve policore-ushtarake të Serbisë, Lugina intensivisht po boshatiset nga shqiptarët, jo vetëm selektivisht si përpara (sipas moshës, gjinisë, profesionit, nivelit të arsimit dhe veçorive të tjera), por në procesin e braktisjes po marrin pjesë familje të tëra dhe shumë vendbanime kanë mbetur pa njerëz, duke u mbyllur edhe shtëpitë, dhe rrjedhimisht duke u zvogëluar në mënyrë drastike numri i nxënësve dhe paraleleve në klasat e ulëta të shkollës fillore si indikator kryesor i procesit intensiv emigrues dhe i regresit të përgjithshëm demografik. Në shumë mjedise të Luginës, por edhe në nivel të saj këto dy dekadat e fundit, emigrimi gëlltiti jo vetëm pjesën dërmuese të shtimit natyror, por edhe masën demografike më parë të pranishme, që është fenomeni më i pavolitshëm në zhvillimin popullativ të një territori a bashkësie etnike.²¹ Këtë e shohim edhe nga të dhënat e kësaj table, ku shihet qartë se numri i banorëve shqiptarë në Preshevë në vitin 1991 ka qenë më i lartë se në vitin 2002.

Përbërja Etnike					
Viti	Serb	%	Shqiptar	%	Total
1961	6,741	25.21%	18,229	68.18%	26,738
1971	5,777	19.22%	23,625	78.60%	30,057
1981	4,204	12.38%	28,961	85.31%	33,948
1991	3,206	8.23%	34,992	89.85%	38,943
2002	2,984	8.55%	31,098	89.10%	34,904

(Tab.1 Përbërja etnike në Komunën e Preshevës).²²

Komuna e Preshevës ka një popullsi shumicë shqiptar që flasin dialektin Gegë dhe popullsinë serbe pakicë që flasin dialektin Torlak. Përqindja e popullsisë shqiptare në Preshevë është mbi 96 % që njëherësh e bën qytetin me më shumë shqiptarë në Serbi.

Banoret e Preshevës janë kryesisht me fenë islam dhe ka 4 Xhami. Shumica e fshatrave janë me shumicë shqiptare përveç fshatrave: Lanik, Svinisht, Savojec, Cakanoc dhe

²¹ <https://telegrafi.com/nje-studim-per-luginen-e-presheves/>

²² Popis stanovništva I stanova 1961, 1971, 1981, 1991, 2002

Mamicë ku serbët janë shumicë. Gjithashtu, shumë fshatra kanë përbërje prej 99 % shqiptarë si: Rahovicë, Miratoc, Geraj etj., dhe fshatrat që janë etnikisht të përziera si: Bushtran, Golemidoll, Leran, Strezoc, Tërnavë, Çukarkë dhe vetë qyteti Preshevë. Presheva, Medvegja dhe Bujanoci përbëjnë treshen e mbetur jashtë territorit kulturor të Shqiptarëve.

3. Statuti i Komunës së Preshevës

Më këtë Statut në pajtim me Ligjin rregullohen të drejtat dhe detyrat e komunës së Preshevës, mënyra, kushtet dhe forma e realizimit të tyre, format dhe instrumentet e realizimit të drejtat njerëzore dhe të drejtat në pakicave në komunë, numri i këshilltarëve të Kuvendit të komunës, organizimi dhe puna e organeve në shërbim, mënyra e pjesëmarrjes së qytetarëve në udhëheqjen dhe vendosjen mbi punët nga kompetenca e komunës, themelimi dhe puna e bashkësive lokale dhe format tjera të vetëqeverisjes vendore, bashkëpunimi dhe bashkimi i komunave, mbrojtja e vetadministrimit lokal si dhe çështjet tjera me rëndësi për komunën. Komuna është njësi territoriale në të cilën qytetarët realizojnë të drejtën në vetadministrim lokal në pajtim me kushtetutën, ligjin dhe këtë statut. Qytetarët të cilët kanë të drejtë votimi dhe vendbanim në territorin e komunës, udhëheqin me punët e komunës në pajtim me ligjin dhe këtë statut. Qytetarët marrin pjesë në realizimin e vetadministrimit lokal me anë të iniciativës qytetare të tubimit të qytetarëve, referendumit formave tjera të pjesëmarrjes së qytetarëve në kryerjen e punëve të komunës dhe nëpërmes të këshilltarëve të vetë Kuvendit të komunës në pajtim me Kushtetutën, Ligjin dhe këtë Statut.

Territorin e Komunës së Preshevës të përcaktuar me ligj e përbëjnë vendbanimet, gjegjësisht territoret dhe komunat kadastrale edhe atë:

Nr	Vendbanimet	
1	Geraj	Geraj
2	Bërçec	Bërçes
3	Buhiç	Buhiç
4	Bukoc	Bukoc 1
5		Bukoc 2
6	Bushtran	Bushtran
7	Gare	Gare
8	Golemidoll	Golemidoll

9	Shoshaj e Epërme	Shoshaj e Epërme
10	Gosponica	Gosponica
11	Depca	Depca
12	Shoshajë e Poshtme	Shoshajë e Poshtme
13	Zhunica	Zhunica 1
14		Zhunica 2
15	Ilinica	Ilinica
16	Kurbali	Kurbali
17	Lanik	Lanik
18	Maxhere	Maxhere
19	Miratoc	Miratoc
20	Norçë	Norçë
21	Rahoviçë	Rahoviçë
22	Peçënë	Peçënë
23	Preshëv	Preshev
24	Raincë	Raincë
25	Ranatoc	Ranatoc
26	Levan	Levan
27	Svinjishtë	Svinjishtë
28	Sefer	Sefer
29	Slavujevcë	Slavujevcë
30	Stance, Lezballi	Stanec
31	Strezoc, Hashanët, Mamuj	Strezoc
32	Tërnavë, Reka e Trnavë i Trnavës	
33	Cakanoc	Cakanoc
34	Caravajkë	Caravajkë
35	Çukuarkë	Çukuarkë

(Tab 2. Vendbanimet në Komunën e Preshevës)²³

²³Statuti i Komunës së Preshevës

Komuna e Preshevës ka cilësinë e personit juridik. Në territorin e komunës së Preshevës në përdorim zyrtar të barabartë janë gjuha serbe me shkrim cirilik dhe latin dhe gjuha shqipe me shkrim etj. Komuna ka simbolet e veta stemën dhe flamurin: përdorim i flamurit dhe stemës më për së afërmi me Vendimin e Kuvendit të Komunës mund të vihet krahas simboleve shtetërore. Në lokalet zyrtare të organit të komunës vihet simbolet shtetërore dhe stema dhe flamuri i komunës së Preshevës. Komuna ka festën e saj. Dita e komunës caktohet me vendim të Kuvendit komunal. Organet kanë vula.

Komuna ndan shpërblime dhe mirënjohje tjera publike organizative dhe qytetarëve për realizime të rëndësishme në prodhim shkencë, krijimtari dhe në lëmit tjera shoqërore. Llojet e shpërblimeve dhe mirënjohje tjera publike kushtet dhe mënyra e ndarjes së tyre rregullohet me vendim të posaçëm të Kuvendi të komunës. Komuna përcakton emërtimin e rrugëve, shesheve të qytetit dhe pjesëve tjera të vendbanimeve në territorin e vetë me Vendim të veçantë me pëlqim e mëparshme të Ministrisë kompetentet për punët e vetadministrimit lokal. Në procedurën e ndryshimit të emërtimit të rrugëve, shesheve dhe pjesëve tjera të vendbanimit merret edhe mendimi i Pleqësisë Nacionale të pakicave kombëtare.

3.1 Puna publike

Puna e organit të komunës së Preshevës është publike. Puna publike sigurohet më anë të nxjerrjes së revistave, informatorëve, bashkëpunimin me internet, mediat, prezantimin e vendimeve dhe me akte tjera të opinionit me anë të prezantimit në internet. Me organizimin e diskutimeve publike në pajtim me Lligjin këtë statut dhe vendimet e organeve të komunës. Komuna, informatat dhe lajmërimet e veta i shpallë edhe në gjuhët që janë në përdorimin zyrtar që janë të përcaktuara në këtë Statut. Komuna ka pronën e vet. Me pronën e komunës në mënyrë të pavarur udhëheqin dhe disponojnë organet komunale në pajtim me Ligjin.²⁴

3.2 Kompetencat e Komunës

Komuna kryen punët e veta në mënyrë të pavarur udhëheqjen dhe disponojnë organet komunale në pajtim me ligjin. Komuna në kryerjen e kompetencave të veta nëpërmjet organeve në pajtim me ligjin dhe kushtetutën: nxjerr Programet e zhvillimit, nxjerr Planet urbanistike, miraton buxhetin dhe llogarinë përfundimtare, përcakton shkallët e të hyrave

²⁴Statuti i Komunës së Preshevës

burimore të komunës si dhe mënyrën dhe masat për caktimin e lartësisë së taksave dhe kompensimeve lokale, rregullon dhe siguron kryerjen dhe zhvillimin e veprimtarive komunale, spastrimin dhe distribuimin e ujërave, spastrimin dhe derdhjen e ujërave atmosferikë dhe ujërat e ndotura, vijën e bartjes së udhëtarëve në qytetet dhe jashtë qytetit të udhëtarëve në komunikacionin tokësor, shfrytëzimin e tregut, parqeve, gjelbërimit, vendeve rekreative dhe sipërfaqeve të varrimit, përkujdeset mbi mirëmbajtjen e ndërtesave banesore dhe sigurisë së shfrytëzimit të tyre dhe përcakton lartësinë e kompensimit për mirëmbajtjen e ndërtesave banesore, zbaton procedurën e largimit të personave të vendosur pa të drejtë në banesa dhe lokale të përbashkëta në ndërtesat banesore, nxjerr programet dhe zbaton projekte të zhvillimit lokal ekonomik dhe përkujdeset mbi avancimin e ambientit të përgjithshëm të afarizmit, nxjerr programet dhe zbaton projekte të zhvillimit lokal ekonomik dhe përkujdeset mbi avancimin e ambientit të përgjithshëm të afarizmit në njësinë e vetadministrimit lokal, rregullon dhe siguron shfrytëzimin e lokalit afarist dhe bënë mbikëqyrjen ndaj shfrytëzimit të lokalit afarist, përkujdeset mbi mbrojtjen e mjedisit jetësorë nxjerr programe të shfrytëzimit dhe mbrojtjen e vlerave natyrore dhe programe të mbrojtjes jetësor, gjegjësisht plane lokale aksionare dhe të sanimit në pajtim me dokumentet strategjike dhe me interesa dhe specifitetet e veta dhe përcakton kompensimin e veçantë, rregullon dhe siguron kryerjen e punëve që mbështetet në ndërtimin, rehabilitimin dhe rekonstruktimin mirëmbajtjen mbrojtjen, shfrytëzimin, zhvillimin dhe udhëheqjen e rrugëve lokale të pakategorizuara dhe rrugëve në vendbanime, rregullon dhe siguron kushte të veçanta dhe organizimin e bartjes së udhëtarëve me autotaksi, grumbullon rezerva të mallit dhe përcakton sasinë dhe strukturën e tyre, themelon institucione dhe organizata në lëmin e arsimit fillor, kulturës, mbrojtjes primare të shëndetësisë, kulturës fizike, sportit, mbrojtjes së fëmijëve dhe turizmit, themelon institucioneve në lëmin e mbrojtjes sociale dhe përcjell dhe siguron funksionimin e tyre, jep leje për fillimin e punëve të institucioneve të mbrojtjes sociale të cilat i themelojnë personat e tjerë juridik dhe fizik vërteton plotësimin e kushteve për ofrimin e shërbimeve të mbrojtjes sociale, vërteton normativat dhe standardet për kryerjen e veprimtarisë së institucionit themelues i të cilit është nxjerrë dispozita mbi të drejtat në mbrojtjen socialen dhe kryen punët e të përkujdesurit shtetërorë, organizon kryerjen e punëve lidhur me mbrojtjen e të mirave kulturore me rëndësi për komunën, nxit zhvillimin e krijimtarisë kulturore dhe artistike siguron mjete për financim dhe sufinancim të programeve dhe projekteve, organizon mbrojtjen dhe fatkeqësitë elementare dhe fatkeqësitë më të mëdha elementare mbi zjarr dhe krijon kushte për mënjanimin e tyre gjegjësisht zbutjen e pasojave të tyre.

Për realizimin e të drejtave dhe detyrave të veta dhe për plotësimin e nevojave të banorëve lokal komuna mund me vendim special të themelojë, ndërmarrje, institucione dhe organizata të tjera që kryejnë shërbime publike. Në Statut për ndërmarrje publike dhe institucione publike ku është themelues komuna pëlqimin e jep Kuvendi i Komuës.²⁵

3.3 Financimi i punëve të Komunës

Kryerja e punëve të komunës që janë të caktuara me Kushtetutë, me Ligj dhe për punët e besuara nga suazat e të drejtës dhe detyrave të Republikës i takojnë të hyrat e caktuara me Ligj. Punët e komunës financohen nga burimet dhe të hyrat e ceduara, transferet të ardhurat në bazë të huazimit dhe të hyrat tjera të caktuara me ligj. Për kryerjen e punëve të komunës të cilat janë të përcaktuara me kushtetutë dhe me ligj, gjegjësisht për kryerjen e punëve të besuara nga të drejtat dhe detyrat e Republikës, si dhe për kryerjen e punëve të veçanta të cilat me vendim të vetë Republika ia beson Komunës i takojnë të hyrat e caktuara me ligj. Të gjitha të hyrat e komunës janë të hyrat e përgjithshme të buxhetit dhe mund të shfrytëzohen për çfarëdo dedikimi, përveç atyre të hyrave karakteri i të cilave është u caktuar me Ligj. Kuvendi miraton buxhetin e komunës për çdo vite kalendarik, në të cilën paraqiten të gjitha të hyrat, huazimet dhe transaksionet financiare, të dalurat dhe të dhënat tjera në pajtim me Ligjin. Për vitin e shkuar për të cilin buxheti është nxjerr përpilohet edhe llogaria përfundimtare mbi kryerjen e buxhetit. Vendimin mbi buxhetin dhe llogarinë përfundimtare Kuvendi e miraton me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve.

Për ekzekutimin e buxhetit të komunës është përgjegjës kryetari i komunës dhe i përgjigjet Kuvendit të komunës. Administrata komunale është e obliguar që rregullisht të përcjell zbatimin e buxhetit dhe sipas nevojës, më së paku dy herë në vit ta informon kryetarin e komunës, kurse për plotësimin e nevojave të qytetarëve në komunë apo në ndonjë pjesë të saj mjetet mund të grumbullohen me vetëkontribut. Kuvendi i komunës vërteton propozim vendimin mbi vetëkontributin me shumicë votash nga numri i tërësishëm i këshilltarëve. Vendimi mbi kryerjen e vetëkontributit konsiderohet si i nxjerr kur për të janë deklaruar shumica nga numri i tërësishëm i qytetarëve të cilët kanë të drejtë në zgjedhje dhe vendbanim në territorin ku mjetet grumbullohen si dhe qytetarët të cilët kanë në atë territor pasuri të patundshme. Me iniciativën për udhëheqjen e vetëkontributit, përveç çështjes së

²⁵ Statuti i Komunës së Preshevës

caktuar që është lëndë e iniciativës paraqitet edhe programi që vërteton zgjedhjet, dedikimet dhe mjetet e tërësishme financiare që duhet të sigurohen nga vetëkontributi për realizimin e projekteve të caktuara (ujësjellësi, rruga, shkolla dhe të ngjashme).²⁶

3.4 Raportet e organeve të Republikës, autonomisë territoriale dhe i organeve të njësive të Vetadministrimit Lokal

Organet e Republikës, autonomisë territoriale dhe organet e vetadministrimit lokal, me qëllim të realizimit të të drejtave dhe obligimeve të tyre, bashkëpunojnë mes veti në pajtim me kushtetutën, ligjin dhe me rregulla të tjera. Organet e Republikës dhe të autonomisë territoriale ushtrojnë mbikëqyrje ndaj ligjshmërisë së punës dhe akteve të organeve të njësisë së vetadministrimit lokal, në pajtim me Kushtetutën dhe ligjin. Organi kompetent i njësisë së vetadministrimit lokal është i obliguar që me kohë t’ia dërgoj të dhënat e kërkuara, shkresat dhe dokumentet e organit të Republikës ose krahinës autonome e cila bënë mbikëqyrjen e ligjshmërisë së punës dhe akteve të njësisë së vetadministrimit lokal.

Për dërgimin e të dhënave, shkresave dhe dokumenteve të kërkuara përgjegjës është kryetari i komunës, përkatësisht sekretari i kuvendit të komunës nëse bëhet mbikëqyrja mbi punën dhe aktet e kuvendit të komunës, ndërsa organet dhe shërbimet e njësive të veta iu japin organeve Republikane dhe autonomie territoriale iniciativa për rregullimin e raporteve me rëndësi për vetadministrimin lokal dhe gjithashtu për ndërmarrjen e masave me rëndësi për zgjidhjen e çështjeve nga kuadri i të drejtave dhe obligimeve të njësisë së vetadministratës lokale; paraqesin parashtresa dhe japin propozime sa i përket veprimit të organeve të Republikës dhe autonomisë territoriale; kërkojnë mendimin nga organi kompetent i Republikës dhe autonomisë territoriale lidhur me zbatimin e ligjit dhe të rregullave të tjera që janë me ndikim të drejtpërdrejtë në zhvillimin dhe realizimin e njësive së vetadministratës lokale dhe për punën e organeve të njësisë së vetadministrimit lokal; marrin pjesë, të pavarur apo përmes asociacioneve të veta në përgatitjen ligjeve dhe rregullave të tjera përmbajtja e të cilave është me rëndësi të veçantë për realizimin dhe zhvillimin e vetadministrimit lokal.

Organet e Republikës dhe autonomisë territoriale gjatë ushtrimit të kompetencave të veta: njoftojnë organet dhe shërbimet e njësive së vetadministrimit lokal, me vetiniciativë ose

²⁶ Statuti i Komunës së Preshevës

me kërkesën e tyre, për masat të cilat i ndërmarrin ose synojnë t'i ndërmarrin në ekzekutimin e ligjit dhe të rregullave të tjera, për mbrojtjen e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë, dukuritë të cilat i rrënojnë ato dhe për masat për mënjanimin e tyre, për realizimin e të drejtave të qytetarëve në vetadministrim lokal, si dhe për çështjet e tjera me interes të drejtpërdrejtë për realizimin e sistemit të vetadministrimit lokal dhe për punën e organeve të njësisë së vetadministrimit lokal; ofrojnë ndihmë profesionale organeve dhe shërbimeve të njësisë së vetadministrimit lokal lidhur me kryerjen e punëve të tyre, ndërkaq veçmas për aplikimin e sistemit të informacionit dhe të informatizimit të punëve të cilat i kryejnë organet dhe shërbimet e njësisë së vetadministrimit lokal; kërkojnë raporte, të dhëna dhe njoftime për kryerjen e punëve nga kuadri i të drejtave dhe i obligimeve të njësisë së vetadministrimit lokal, si dhe për çështjet e tjera të cilat janë me interes për realizimin e rolit dhe për punën e organeve të Republikës dhe autonomisë territoriale në fushën e vetadministrimit lokal. Qeveria është e obliguar që me anë të aktvendimit, i cili hynë në fuqi pas publikimit në “Gazetën zyrtare të Republikës së Serbisë” ta ndalojë nga ekzekutimi aktin e njësisë së vetadministrimit lokal për të cilin konsideron se nuk është në pajtim me Kushtetutën ose ligjin.

Aktvendimi mbi ndalimin nga ekzekutimi shfuqizohet nëse qeveria në afat prej pesë ditësh nga dita e publikimit të aktvendimit nuk inicion për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së aktit të përgjithshëm. Ministria kompetente do të iniciojë për vlerësimin e kushtetutshmërisë dhe ligjshmërisë së statutit, të rregullave ose të aktit tjetër të përgjithshëm të njësisë së vetadministrimit lokal në Gjykatën kushtetuese, nëse konsideron se ai akt nuk është në pajtim me Kushtetutën, ligjin ose me dispozitë tjetër republikane. Organi kompetent i autonomisë territoriale do të iniciojë procedurën nga paragrafi më lart, nëse konsideron se ai akt nuk është në pajtim me dispozitat krahinore. Në momentin që ministria kompetente për punët e vetadministrimit lokal konsideron se akti i përgjithshëm i organit të njësisë së vetadministrimit lokal nuk është në pajtim me statutin, për këtë do ta paralajmëroj kuvendin e njësisë së vetadministrimit lokal me qëllim të ndërmarrjes së masave përkatëse, ndërsa nëse kuvendi i njësisë së vetadministrimit lokal nuk vepron sipas propozimeve të caktuara, ministria kompetente për punët e vetadministrimit lokal do të iniciojë procedurë në Gjykatën supreme të Serbisë dhe njëkohësisht do t'i propozoj qeveris që ta ndaloj së ekzekutuari aktin e caktuar deri në vendimin e Gjykatës supreme të Serbisë.

Nëse ministria kompetente për punët e vetadministrimit lokal gjen se ndonjë akt i organit, përkatësisht i shërbimeve të njësisë së vetadministrimit lokal, kundër të cilit nuk

është siguruar mbrojtja ligjore, nuk është në pajtim me ligjin ose me ndonjë rregull tjetër, përkatësisht me vendimin ose aktin tjetër të njësisë së vetadministrimit lokal, atëherë i propozon kuvendi njësisë së vetministrimit lokal që atë akt ta heq apo ta anulojë. Po ashtu nëse kuvendi nuk vepron në afat prej një muaji sipas propozimeve të organit ministria kompetente për punët e vetadministrimit lokal do ta heqë ose do ta anulojë aktin. Kuvendi i njësisë së vetministrimit lokal mund të shpërndahet nëse kuvendi nuk mban mbledhje më gjatë se tre muaj. Nëse nuk e zgjedh kryetarin e komunës dhe këshillin e komunal në afat prej një muaji nga dita e konstituimit të kuvendit të njësisë së vetadministrimit lokal ose nga dita e shkarkimit ose dorëheqjes së tyre. Vendimin për shpërndarjen e kuvendit e sjell qeveria me propozim të ministrisë kompetente. Kryetari i kuvendit popullor i shpallë zgjedhjet për këshilltarë në afat prej dy muaj nga hyrja në fuqi e vendimit mbi shpërndarjen e kuvendit. Mandati i këshilltarëve do të zgjasë katër vjet. Deri në konstituimin e kuvendit dhe zgjidhjes së organeve ekzekutive të kuvendit punët e domosdoshme dhe vijuese nga kompetenca e kuvendit dhe organeve ekzekutive të kuvendit i kryen organi i përkohshëm i njësisë së vetadministrimit lokal të cilin e përbejnë kryetari dhe katër anëtarë. Organin e përkohshëm e formon qeveria, gjithashtu qeveria bie aktvendim të veçantë për emërimin e kryetarit dhe të anëtarëve të këtij organi, duke qenë e kujdesshme për përbërjen nacionale dhe politike të kuvendit të shpërndarë.

Nëse në njësinë e vetadministrimit lokal nuk mbahen zgjedhjet për këshilltarë ose nëse pas zgjedhjeve nuk bëhet konstituimi i kuvendit në pajtim me këtë ligj në afat prej dy muaj nga dita publikimit të rezultateve të zgjedhjeve, qeveria e emëron organin e përkohshëm. Kryetari i Kuvendit popullor është i obliguar që vendimin për shpalljen e zgjedhjeve për kuvendin e njësisë së vetadministrimit lokal ta bie në afat prej një muaji, nga dita kur është dashur që zgjedhjet të zbatohen, gjegjësisht të konstituohet kuvendi.²⁷

3.5 Mënyrat nëpërmjet të cilave qytetarët mund të marrin pjesë në procesin e vendimmarrjes në njësitë e Qeverisjes Lokale

Mënyratë nëpërmjet të cilave qytetarët drejtpërdrejt marrin pjesë në marrjen e vendimeve në njësitë e vetëqeverisjes lokale, është e domosdoshme të fillohet nga kornizat normative të cilat rregullojnë këtë pjesëmarrje. Në pika të shkurta do të përmendim aktet juridike më të rëndësishme dhe mënyrat me anë të së cilave rregullohet kjo sferë. Korniza

²⁷ Statuti i Komunës së Preshevës

legjislative bazohet në Kushtetutën e Republikës së Serbisë dhe në aktet ligjore në fuqi; Ligji mbi vetëqeverisjen lokale dhe Ligji mbi referendumin dhe iniciativën qytetare.

Ligji mbi vetëqeverisje lokale parasheh tri mënyra të pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të qytetarëve: iniciativën qytetare (si formë e vendosjes) dhe tubimin e qytetarëve (si mënyrë për konstatimin e propozimeve dhe kërkesave të cilat u drejtohen organeve të vetëqeverisje lokale). Në dy aktet e përmendura ligjore ndodhen dispozita identike në pjesën në të cilën thuhet që Kuvendi Komunal mundet me vetë iniciativë të shpallë referendum mbi çështjet që ndodhen në kompetencat e saja dhe që vendimi mbi referendum sillet nëse për të janë deklaruar shumica e qytetarëve që kanë votuar me kusht që më shumë se gjysma e qytetarëve të kenë votuar për atë vendim. Për të gjitha format e pjesëmarrjes së drejtpërdrejt të qytetarëve, ligji parasheh rregullimin detal nëpërmjet statuteve të komunave dhe qytetarëve.

Me anë të iniciativave qytetare, Kuvendit komunal i propozohen sjelljet e akteve nëpërmjet të cilave rregullohen çështjet e caktuara nën kompetencat e vetëqeverisjes lokale, ndryshimin e statutit ose edhe akteve tjera e po ashtu edhe shpallja e referendumit në përputhshmëri me ligjin dhe statutin.

Dispozitat mbi tubimin e qytetarëve po ashtu janë identike në ligj dhe ato definojnë çështjet mbi rregullimin e tubimeve të qytetarëve, mënyrën e miratimit të propozimeve dhe afatin kohorë brenda të cilit vetëqeverisje lokale duhet të shqyrtoj propozimet dhe kërkesat. Format e pjesëmarrjes së qytetarëve janë: iniciativa qytetar, referendumi, tubimi i qytetarëve, diskutimet publike dhe anketimet publike.

3.5.1 Iniciativat qytetare

Nëpërmjet iniciativave qytetare dorëzohen nënshkrimet me qëllim të ndryshimit të akteve ligjore në vetëqeverisje lokale ndryshimi të statutit, si dhe sjellja e masave të cilat ndodhen në kompetencat e kuvendit. Kuvendi obligohet që të organizoj diskutim mbi çështjet e kërkuara dhe t'i dorëzoj përgjigje qytetarëve në afat prej 60 ditëve. Me anë të statutit definohet numri i nënshkrimeve të nevojshëm për iniciimin e iniciativës qytetare numër ky që nuk mund të jetë më i vogël se 5 % i numrit të përgjithshëm të votuesve të regjistruar në atë komunë. Në bazë të praktikave të deri tanishme është treguar që qytetarët e komunave më të vogla janë më aktiv dhe më shpesh kanë dorëzuar iniciativa në krahasim me qytetarët e vendeve më të mëdha. Iniciativat e qytetarëve më së shpeshti iniciohen për çështjet me të cilat qytetarët ballafaqohen çdo dite: çështje komunale, çështje rreth trafikut, ndihmë për manifestime të ndryshme, etj. Në raste të caktuara, iniciohet ndërrimi i organizimit territorial

të komunës ose qytetit. Iniciativa qytetare është instrument nëpërmjet të cilit qytetarët fitojnë të drejtën që t'i drejtohen kuvendit komunal dhe të i propozojnë aprovimin e ndonjë akti të përgjithshëm (statuti, vendimi, etj) ose të provojnë amendamente rreth akteve të lartë përmendur dhe të kërkojnë që një propozim i tillë, nëse trupi përgjegjës komunal nuk e pranon, të hidhet në votim të qytetarëve. Në bazë të kësaj, një propozim i tillë do të aprovohet nëse pranohet ose nga trupi përgjegjës komunal, ose me shumicë votash. Në këtë mënyrë qytetarët mund të ndryshojnë gjendjen aktuale, pa marrë parasysh nëse pushteti lokal ka aprovuar apo jo ndonjë vendim, dhe një ndryshim i tillë me këtë metodë mund të bëhet qoftë edhe kundër vullnetit të pushteti lokal. Shembull: nëse komuna nuk mundohet të zgjedh problemin e caktuar në trafik, qytetarët e pa kënaqur vendosin të nisin iniciativë qytetare dhe formulojnë propozimin iniciues, në bazë të cilit problemi në fjalë duhet të zgjidhet. Nëse mbledhin numrin e nevojshëm të nënshkrimeve, kuvendi komunal është i obliguar të deklarohet(votojë) rreth atij propozimi. Nëse kuvendi komunal hedh poshtë propozimin iniciues, atëherë iniciohet votimi qytetarë. Vendimi për komunën është obligativ, nëse në atë proces të votimit aprovohet propozimi i qytetarëve.

3.5.2 Referendumi

E drejta për referendum është e drejtë e qytetarëve të votojnë mbi vendimin të cilin e ka aprovuar kuvendi popullor ose lokal dhe në këtë mënyrë vendosin nëse e pranojnë apo jo këtë vendim. Kuvendi Komunal mund të shpall referendum mbi çështjet që janë në kompetenca të komunave, dhe është i obliguar për një gjë të tillë nëse propozohet nga së paku 10% e numrit të votueseve nga numri i përgjithshëm i votueseve në atë njësi lokale. Kuvendi Komunal i njësisve të vetëqeverisjeve lokale mund me vetiniciativë të shpallë referendum mbi çështjet që ndodhen brenda kompetencave të saja. Vendimin mbi shpalljen e referendumit komunal, Kuvendi Komunal e merr me shumicë votash të numrit të përgjithshëm të këshilltarëve. Vendimi merret nëse për referendum kanë votuar shumica e qytetarëve të cilët kanë marr pjesë, me kusht që të kenë votuar më shumë se gjysma nga numri i përgjithshëm i banorëve. Vendimi i dal nga referendumi është i obligueshëm, ndërsa kuvendi komunal nuk mund ta shfuqizojë të njëjtin, e as nuk mund ta plotësojë ose ndryshojë thelbin e saj në periudhë kohore një vjeçare nga dita kur është aprovuar vendimi i marr. Numri më i madh i referendumeve të realizuara ka pas të bëjë më kontributet e qytetarëve dhe me ndryshimin e organizimit territorial, e cila ka të bëjë me bashkimin apo ndarjen e bashkësisë lokale. Organet për realizimin e referendumit janë komisionet dhe këshilli votues. Komisionin e

trajnon organi i cili ka shpallur referendumin, ndërsa komisioni merret me trajnimet e këshillave votuese.²⁸

3.5.3 Tubimi

Tubimi i qytetarëve ftohet për pjesën e territorit të njësisë së vetëqeverisjes lokale të paraparë me statut. Tubimi i qytetarëve diskuton dhe jep propozime dhe kërkesa mbi çështjet që janë në kompetenca të vetëqeverisjeve lokale. Tubimi qytetarë me shumicë votash të të pranishmëve mund të aprovojë propozime, kërkesa, të njëjtat t'ia drejtojë kuvendit ose organeve të caktuara të pushtetit lokal. Organet dhe shërbimet e pushtetit lokal janë të obliguara që në një afat prej 60 ditëve nga dita e mbajtjes së tubimit qytetarët të shtjellojnë kërkesat ose propozimet e qytetarëve dhe të deklarojnë rreth tyre, respektivisht të sjellin vendimin e caktuar dhe për të njëjtin t'i njoftojnë qytetarët. Mënyra e organizimit të tubimit qytetarë, funksionimi, dhe mënyra e vërtetimit të qëndrimit të këtij trupi rregullohet me statutin dhe vendimin e kuvendit komunal. Tubimi qytetar ftohet sipas nevojës së bashkësive lokale, një pjesë të bashkësisë lokale ose më shumë bashkësive lokale së bashku, në bazë të mënyrës së caktuar me anë të statutit të komunës.

3.5.4 Diskutimet Publike

Diskutimi publik është mekanizëm nëpërmjet të cilit përfaqësuesit e pushtetit lokal vijjnë deri tek informacionet mendimet dhe zgjidhjet të cilat i përkasin vendimeve të caktuara. Shfrytëzohet në mënyrë që ushtruesit e pushtetit dhe qytetarët e pushtetit lokal të informohen mbi pasojat eventuale që mund t'i sjellin ndryshimet e propozuara. Komuna nuk ka obligim që propozimet të cilat jepen nga qytetarët në diskutime publike, t'i realizojë, që donë të thotë marrja e vendimeve dhe përgjegjësisë mbetet në organin kompetent të komunës. Edhe një karakteristik e diskutimit publik është që qytetarët, personat profesional dhe përfaqësuesit e pushteti nëpërmjet diskutimeve publike mund të gjejnë zgjidhje më të mira dhe më efikase. Pjesëmarrja e publikut duhet të shihet si pozitive, duke marrë parasysh që kjo është një mundësi e cila i hap dyert e të gjithë të interesuarave (qofshin ato individ apo grupe) që me pjesëmarrjen e tyre t'i kontribuojnë kualitetit të jetesës. Këto janë përparësitë e pjesëmarrjes së

²⁸http://www.kt.gov.rs/images/prirucnik_2017alb.pdf

qytetarëve në marrjen e vendimeve. Sipas statutit të komunës së Preshevës diskutimet publike duhen patjetër organizuar në rastet si në vijim: me rastin e aprovimit të buxhetit të komunës, gjatë aprovimit të planeve strategjike aksionale për zhvillim si dhe planifikimit hapësinor të komunave.

3.5.5 Anketimet

Anketimet paraqesin mundësi për organet komunale që rreth çështjeve që janë në kompetenca të komunës të konsultohen qytetarët. Anketat realizohen, në njëërën anë, që të grumbullohet të dhëna mbi nevojat dhe problemet e qytetarëve, që të radhiten prioritet e realizmit të projekteve të cilat hyn në planifikimet strategjike të zhvillimit të komunës dhe financohen nga buxheti programor në vitet e ardhshme, respektivisht, në anën tjetër, që të testohet se sa janë të kënaqur qytetarët më shërbimet të cilat i ofron komuna dhe të grumbullohen propozimet për avancimin e punës së tyre. Anketat janë anonime janë të formuluar në të dy gjuhët zyrtare(serbisht dhe shqip). Anketat mund të sigurohen nëpër qendrat e asistencës, zyra për zhvillimin ekonomi lokal dhe në disa punkte tjera në komunë. Rreth anketimit qytetarët njoftohen nëpërmjet mjeteve të informimit dhe webseit-it të komunës, ndërsa rezultatet e të njëjtave po ashtu bëhen publike.²⁹

4. Shërbimet lokale që ofrohen nga Komuna e Preshevës(infrastruktura, arsimi, shëndetësia etj).

Funksioni kryesor i sistemit të vetëqeverisjes lokal në Preshevë është i orientuar në ofrimin e shërbimeve sa më cilësore. Shërbimet krijojnë lidhjen ndërmjet PL dhe të qytetarëve dhe në të njëjtën kohë, PL e ruan lidhjen edhe me PQ. Për ofrimin e shërbimeve administrata lokale ka shumë të punësuar, të cilët kanë kapacitete të nivelit të mesëm për përmbushjen e kërkesave të palëve të interesuara³⁰. Shërbimet janë produkte të cilat komuna u ofron qytetarëve të saj në bazë të nevojave dhe kërkesave të vlerësuara dhe të sanksionuara me akte administrative dhe ligjore. Në bazë të vlerësimit të nevojave që kanë qytetarët, grupet e ndryshme të interesit dhe komunitetet, PL nëpërmjet kornizës ligjore dhe dokumenteve tjera administrative ika sanksionuar fushat kryesore në të cilat komunat ofrojnë shërbime për qytetarët dhe grupet e interesit. Fushat themelore të ofrimit të shërbimeve janë të lidhura me

²⁹Statuti I Komunës së Preshevës

³⁰ MAPL: “Raport i Vlerësimit të Kapaciteteve në Komuna”, Prishtinë 2011.

të drejtën e plotë të komunës për ofrimin e këtyre shërbimeve (kompetencat vetanake). Këto janë shërbimet që komuna ka obligim themelor t'iu ofrojë qytetarëve me aktin e themelimit të saj. Në kuadër të secilës prej këtyre fushave ofrohet një numër më i madh i shërbimeve specifike për qytetarët.³¹

Si shërbime themelore janë: shërbimet administrative, menaxhimi i financave, zhvillimi ekonomik lokal, menaxhimi i tokës bujqësore dhe zhvillimi i saj, shërbimet publike komunale (furnizimi me ujë, kanalizimi, mbeturinat), mbrojtja e mjedisit, ofrimi i shërbimeve shëndetësore, ofrimi i shërbimeve arsimore, mbrojtja e trashëgimisë kulturore e shumë shërbime tjera.

4.1 Shërbimet Publike të Ndërmarrjeve Publike

Ndërmarrjet Publike janë ato organizata të themeluara nga komunat që kryejnë shërbime publike në komunë. Ato i kryejnë të gjitha shërbimet për të cilat janë të regjistruara ose të specializuara e që hyjnë në kompetenca e në përgjegjësi të tyre. Këto ndërmarrje janë të detyruara t'i dorëzojnë Kuvendit të Komunës buxhetin e tyre për miratim. Është një afat kohor që i detyron ato për të bërë këtë punë (të dorëzojnë projektin e tyre për të hyrë në buxhetin vjetor), në mënyrë të të fitojnë të drejtën e pjesëmarrjes apo të marrjes së mjeteve të duhura për t'i realizuar veprimtaritë e tyre që u përkasin shërbimeve publike³². Komuna e Preshevës ka disa ndërmarrje publike e ato janë: OKF- Organizata për Kulturë Fizike, Moravica- Ndërmarrja publike për furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm grumbullimin e mbeturinave dhe ujërave fekale në qytetin e Preshevës etj.

5. Problemet në disa fusha të caktuara në Komunën e Preshevës

5.1 Infrastruktura

Sa i përket infrastrukturës e dimë se sot gjendja e saj është e mjerueshme dhe ashtu do të vazhdojë edhe për shumë kohë, derisa rinia jonë nuk do të merr një iniciativë dhe të bëjë ndryshimet e duhura me kohë dhe të ngrit zërin e saj. Infrastruktura e Preshevës ka nevojë për rregullimin e rrugëve, trotuareve e po ashtu edhe vendeve relaksuese siç janë: parqet, gjelbërimin dhe ndriçimin e rrugëve, nga mendoj se këto do të bënin jetën e qytetarëve shumë

³¹ ASK: "Popullsia sipas Gjinisë, Etnicitetit dhe Vendbanimit", Prishtinë, 2011

³² <https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/02/Qeverisja-vendore-ne-Kosove.pdf>

më të mirë dhe, po ashtu, edhe do të ishte një mundësi për punësimin e disa punëtorëve të këtij qyteti.

Në kuadër të këtij sektori është Ndërmarrja Publike “Moravica”. Kjo ndërmarrje ka për qëllim furnizimin e qytetarëve me ujë të pijshëm grumbullimin e mbeturinave dhe ujërave fekale në qytetin e Preshevës, në këtë sektor problem është grumbullimi i të hollave për shërbimin të cilin e kryejnë, problem gjithashtu është edhe vendi i deponimit të mbeturinave i cili tani për tani nuk është aspak i përshtatshëm sepse në vendin ku ndodhen tani mbeturinat, rrugës për Gjilan nuk është vend i përshtatshëm as për natyrën e gjelbërimit por as edhe për njerëzit. Pas pranimit të mbi 1000 kontejnerëve si fondacion që kishin marr, kanë shpërndarë nëpër rrugët kryesore të qytetit ku mund të qarkullojnë edhe kamionët, e të tjerët i ndan nëpër lagje tjera sipas nevojës. Sa i përket rezervave dhe burimeve nga të cilat i furnizohen qytetarët janë tri, dy të Karadakut dhe një e Zhunicës dhe për këtë nuk ka pasur problem dhe s’do të ketë deri atëherë kur uji nuk keqpërdoret nga qytetarët. Por, në përgjithësi nuk është në gjendje të mirë, sepse ka probleme me mbledhjen e borxheve nga qytetarët e kësaj komune, ku borxhi konsiderohet të jetë më shumë se 35 milionë dinarë (350 mijë euro). Në listën e borxhlinjve janë edhe qytetarë të tillë, të cilët i kanë borxh edhe më shumë se 170 mijë dinarë (mbi 1 700 euro), pavarësisht se kishin kërkuar ndihmë nga gjyqësia, atyre u kishin kthyer përgjigje se nuk kanë çfarë të bëjnë, nuk kanë çka t’i marrin Shembull për një muaj kishin përgatitur faturat për qytetarët të cilët kapin vlerën e rreth 2 milionë dinarë (mbi 20 mijë euro), ndërkohë që nga të gjitha këto fatura ata mund të mbledhin jo më shumë se 700 mijë dinarë (7 mijë euro). Problem të cilin kishin në financat e NP “Moravica” ishte numri shumë i madh i punëtorëve. Duke pasur parasysh që në strukturën e të punësuarve kishte 55 punëtorë, kështu që e kishte të vështirë që të grumbullojë para edhe për pagat e tyre, duke pasur këtu parasysh edhe riparimet apo intervenimet në mjetet punuese.³³

5.2 Shëndetësia

Presheva është përballur gjithmonë me problemet e shëndetësisë, problemet në shëndetësi janë të shumta, duke filluar nga kushtet dhe furnizimi, e pastaj politikat shëndetësore zhvillimore lokale e shtetërore, pasi në Preshevë ka mbetur niveli primar i shëndetësisë dhe ende nuk qasje për zhvillimin e nivelit sekondar. Në Preshevë funksionon

³³<http://www.preshevajone.com/naser-sadiku-qytetaret-e-presheves-ne-np-moravica-cdo-muaj-hyjne-veresi-nga-17-mije-euro/1347694016000/>

Shtëpia e shëndetit me stacionet shëndetësore në fshatrat Miratoc, Leran dhe Raincë, si dhe ambulancat shëndetësore në fshatrat Rahovicë, Corroticë, Strezoc dhe në Stacionin hekurudhor. Sa i përket fshatrave të Karadakut më herët ka pasur ambulancë në Caravajkë, por për shkak të numrit tejet të vogël të pacientëve ambulanca në Caravajkë është mbyllur. Pas disa viteve kërkesash e bisedimesh, në korrik të vitit të kaluar në kuadër të Shtëpisë së shëndetit në Preshevë u hap materniteti jashtëspitalor, në të cilin deri më tani janë kryer shumë lindje. Kjo ka mundur të hapet shumë më herët, para 10 - 12 viteve, por ka pasur rezistenca politike, prej nivelit qendror, e për fat të keq edhe në nivel lokal nga pushtetet lokale.

Në shtëpinë e shëndetit në Preshevë janë të punësuar 217 punëtorë, prej tyre 53 janë mjekë, 43 të punësuar janë punëtorë jo-medicinal, ndërsa tre prej tyre janë punëtorë që pagat ua siguron pushteti lokal. Shtëpia e Shëndetit ka nevojë për mjekë, pasi mjekët që janë pensionuar e gjithashtu edhe ata që kanë shkuar për specializim, nuk po mund t'i zëvendësojnë. Në punësime në shëndetësi, për fat të keq ka ndikim politika. Ka raste të nepotizmit, familjarizimit dhe animet politik nga drejtorët politik që vendosen. Për fat të keq, kjo është e përhapur shumë. Kjo duhet të ndalet në mënyrë që njerëzit e merituar të vijnë në vendet e merituar të punës, por strukturat aktuale nuk kanë disponim për lëvizje të këtilla.. Donacionet që po jepen nga organizatat joqeveritare, kanë bërë që kjo shëndetësi të fillojë të përmirësohet sado pak dhe të ofrojë kushte pak më të mira. Së fundmi, Shtëpia e shëndetit në Preshevë ka përfituar një donacion nga ambasada e Italisë në Beograd, një auto-kombi saniteti edhe pse shtëpia e shëndetit gjithherë ka nevojë për pajisje të reja medicinale.³⁴

5.3 Bujqësia

Komunën e Preshevës ky sektor kishte mundur që të nxjerrë sadopak nga kriza e tanishme, si duke ditur se fshatrat e komunës sonë janë me një pozitë shumë të mirë dhe me kushte shumë të mira klimatike dhe nëntokësore. Me mbjelljen dhe kultivimin e këtyre fushave, komuna jonë do të ketë mundësi jo vetëm t'i plotësojë nevojat e popullatës, por edhe të bëjë biznes me shtetet e Maqedonisë dhe të Kosovës. Si p.sh.: mbjellja e patateve që është një kërkesë edhe në vendet Evropiane, mbjellja e shalqirit e specave dhe, po ashtu, edhe të domateve. Qyteti i Preshevës gjithmonë ishte i njohur edhe me prodhimin e duhanit nga edhe kishte fabrikën e grumbullimit më të madh në rajonin e Vranjës, e sot nuk kemi prej tyre fare

³⁴<http://lugina-lajm.com/2017/02/shtepia-e-shendetit-ne-presheve-fiton-donacion-prej-100-mije-eurove/>

që bëjnë mbjelljen e saj apo një numër shumë i vogël. Edhe pse në kuadër të këtij sektori është Fondi Komunal për Bujqësi, i cili jep disa subvencione për bujqësi, blegtori dhe bletari, por këto subvencione nuk shpërndahen në mënyrë reale. Qyteti jonë ka nevojë shumë për kuadro të ri dhe për rini të shkolluar në drejtime të ndryshme e jo siç është gjendja momentale që ka më shumë në sektorin e avokaturës dhe ekonomisë. Nga dhe nuk kanë mundësi që të kontribuojnë për qytetin tonë mbasi që nuk ka vende ku do të punësohen. Preshevës i duhet të kenë më shumë fabrika të hapura, më shumë lobim në shtetet e huaja për stimulimin e tyre për hapjen e bizneseve të tyre në qytetin tonë. Sa më shumë që do të sjellim biznes të huaj apo edhe atyre vendore, ne do të kemi më shumë qytetar në Preshevë dhe do të kemi më shumë rini e më shumë popullsi.³⁵

5.4 Edukimi dhe Kultura

Komuna e Preshevës ka Shtëpinë e Kulturës “Abdullah Krashnica”, të cilën e financon vetë komuna dhe ka 17 punonjës. Jeta kulturore në Preshevë lidhet kryesisht me manifestimet në shtëpinë e kulturës “Abdulla Krashnica”. Prej vitit 1992, çdo qershor organizohet festivali i trashëgimisë kulturore shqiptare (folklorit, dramës, poezisë dhe prozës). Në ndërtesën e Shtëpisë së Kulturës gjendet biblioteka, kinemaja, zyrat e organizatave të qytetarëve dhe TV Presheva. Në këtë komunë ka edhe disa organizata joqeveritare të cilat me aktivitetet e tyre ndikojnë në jetën politike, ekonomike dhe kulturore të qytetarëve. Organizatat joqeveritare në Preshevë shihen si potencial më i madh në resurset njerëzore. Personat të cilët janë të angazhuar llogariten si të arsimuar, profilizuar në njohuri, entuziast dhe fleksibil në punë, të natyrës kritike, inovative dhe të aftë të përgjigjen shpejt në problemet e perceptuara në shoqëri. Gjithashtu në tetor të vitit 2010 në Preshevë është krijuar Shoqata për Trashëgimi dhe Krijimtari Kulturore.³⁶

Komuna e Preshevës ka 10 shkolla, 8 fillore dhe 2 të mesme më përafërsisht 8.000 nxënës. Ku në shkollat e mesme në Preshevë përafërsisht të 2500 nxënës edhe atë në shkollën Teknike „Presheva“ (1500) dhe Gjimnazi „Skendrbeu“ (me 1030 nxënës). Këto financohen nga Ministrit përkatëse, kurse vetëm për disa shpenzime materiale financohet nga buxheti komunal.

³⁵<http://www.titulli.com/index.php?m=post&s=26243>

³⁶<https://sq.wikipedia.org/wiki/Presheva>

Mungesa e teksteve shkollore dhe moslejimi i përdorimit të teksteve nga Kosova, paraqesin problem serioz për nxënësit e të gjitha niveleve në Luginë. 5000 tekste shkollore në gjuhën shqipe, të dërguara nga Kosova, që mbahen të konfiskuara nga policia e Serbisë tani e disa vite dhe moslejimi as i Abetares, paraqesin formën më të vrazhdë të diskriminimit kombëtar në një vend evropian që po e synon integrimin në BE. Ato pak libra të përkthyer në gjuhën shqipe që janë në përdorim atje janë botime të vjetra, shumë prej tyre janë të viteve 70- ta. Serbia jo vetëm se nuk e lejon përdorimin e teksteve shqip nga Kosova, por as nuk pranon të bisedon për mundësinë e shfrytëzimit të teksteve nga Kosova në Luginën e Preshevës.

Numri i nxënësve në shkollat e kësaj komune dita ditës është duke u zvogëluar, ku dimë se arsyeja e zvogëlimit të këtij numri është nga kushtet e vështira për mbijetesë dhe një numër i tyre janë që kanë ikur për jetë më të mirë. Shkolla fillore në këtë qytet ishte njëherësh edhe ndër shkollat që ka prodhuar nxënës të shkëlqyeshëm sidomos në matematikë dhe lëndë shkencore e cila edhe është krahasuar me shkollat e qyteteve si Prishtinë, Tetovë, Vranjë, e po ashtu edhe kishin sjellë edhe dëftesa të vendit të parë e dytë. Po sot kushtet e kësaj shkolle janë shumë të mjerueshme dhe me përgatitje shumë të ulët, e po ashtu edhe me mungesë të literaturave të ndryshme. Kjo shkollë sot ka disa paralele më pak se sa kishte në dekadën e fundit, nga si pasojë është papunësia dhe niveli i mësimi. Sa i përket shkollës së mesme ajo është sa për të thënë që ekziston si shkollë, ku shohim shumë nxënës të kësaj shkolle që nuk kanë përgatitjet e duhura për vijimin e mësimave. Ata kanë për qëllim pothuajse të gjithë të largohen nga komuna e Preshevës drejt vendeve të Evropës ose të studiojnë në Shqipëri, Maqedoni dhe në Kosovë dhe të mos kthehen më në Preshevë. Kufizimi i regjistrimit të studentëve në këto vende, sidomos për fushat në të cilat mungojnë kuadrot në Luginë shkakton mungesë të kuadrove profesionale në Luginë. Në këto rrethana Lugina ka nevojë për një universitet të vetin. Mungesa e kuadrit të kualifikuar për shkak të mosnjohjes së diplomave të universiteteve të Kosovës, pasi që Gjykata Kushtetuese e Serbisë marrëveshjen e arritur në Bruksel në lidhje me nostrifikimin e ka shpallur jo kushtetues, është po ashtu problem i madh për shqiptarët e Luginës. Serbia nuk i njeh as diplomat e shkollave të mesme dhe as dëftesat e shkollës fillore nga Kosova.³⁷

³⁷<http://www.kosovapress.com/sq/opinione/ismajl-kurteshi-170/shqiptaret-e-lugines-se-presheves-jane-komuniteti-me-i-diskriminuar-ne-evrope-38381/>

5.5 Ekonomia

Gjatë dy viteve të fundit pavarësisht përpjekjeve të ndryshme nga ana e pushtetit qendror, pushteti lokal si dhe organizatave ndërkombëtare për përmasimin e situatës ekonomike në Luginën e Preshevës, niveli i dëshirueshëm i zhvillimit ekonomik është ende larg arritjes. Një prej zgjidhjeve të ofruara nga shteti ka qenë krijimi i Trupit Koordinues të Qeverisë së Serbisë për komunat e Preshevës, Bujanovcit dhe Medvegjës më 16 dhjetor të vitit 2000. Krijimi i këtij Trupi Koordinues në politikën e qeverisë serbe shënoi një qasje të re për zgjidhjen e tensioneve ekzistuese etnike në rajon. Fushat prioritare të veprimit të Trupit Koordinues në tre komunat janë: arsimi, çështjet sociale, zhvillimi ekonomik dhe forcimi i kapaciteteve të shoqërisë civile.

Për shkak të normës së lartë të papunësisë, popullata në këtë rajon po përballet me problemin e një standardi shumë të dobët të jetesës. Fuqia blerëse mbetet e dobët ndërkohë që kërkesa sillet kryesisht rreth produkteve dhe shërbimeve më themelore. Me karakteristika të tilla, tregu, në mënyrë individuale në secilën komunë, mund të konsiderohet si relativisht i vogël dhe mjaft i dobët për vetëzhvillimi. Një treg i tillë nuk është atraktiv për ndërmarrësit potenciale, ndërsa pamundësia për të mbijetuar në një treg të hapur dhe për t'i bërë ballë konkurrencës është një tjetër fakt shqetësues dhe i dëmshëm për sektorin privat. Megjithatë vendi vazhdon të pësojë procesin e tranzicionit, sektori privat ende nuk ka fituar vendin që meriton. Ai mbetet i plogësht dhe si i tillë nuk i shërben qëllimit të tij kryesor.

Viteve të fundit, kriza globale ekonomike ka dobësuar edhe më tej standardin tashmë të dobët të popullatës së këtij rajoni. Duke pasur parasysh se shumë familje të Luginës së Preshevës jetojnë nga remitancat, dobësimi i standardit ekonomik të anëtarëve të familjeve që punojnë jashtë vendit drejtpërdrejtë ka ndikuar së standardin e atyre që varen nga remitancat.³⁸ Po ashtu problem në ekonomi kanë sjell edhe mbylljet e afërsisht 6 fabrika (Kristali, Yumko, Ciku, Simpo, 7- Korriku etj) që kishin funksionuar në komunën tonë e sot kemi vetëm një eventalisht dy prej tyre, nga të cilat janë private dhe pa menaxhimin e Komunës së Preshevës. Një menaxhim i mirë dhe i duhur i kësaj komune do të kishte mundësin që të punësojë një numër shumë të madh dhe për një kohë shumë të shkurtër. Nga ajo që dimë se në këto fabrika kishte të punësuar mbi 2000 persona, sot kjo komunë do të kishte të punësuar po këtë numër të personave dhe asnjë i ri nga kjo komunë nuk do të

³⁸http://www.southeast-europe.org/pdf/16/dke_16_ab_s_Fidan-Kosumi_%20Sfidat-ekonomike.pdf

mendonte që të jetoj diku tjetër por në vendlindjen e tyre. Në bazë të kësaj mundemi të kemi popullatë më të kënaqshme dhe popullatë me standard më të mira e po ashtu edhe shtimi i kësaj popullate do të ishte edhe më e kënaqshme. Në kuadër të këtij sektori është vetëm Fondi Humanitar, ai që nganjëherë i ndihmon ndërmarrjet private.

6. Transparenca në funksionimin e pushtetit lokal në Preshevë

Qeverisja lokale në Preshevë vuan nga shumë të meta strukturore. Transparenca, si parim themelor i qeverisjes së mirë, pa dyshim se, renditet në krye të kësaj liste. Kohëve të fundit, gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë. Kjo analizë e shkurtër bën vlerësimin e transparencës në komunën e Preshevës, përmes këtyre segmenteve: rregullorja për transparencë, qasja në dokumente publike, web-faqja zyrtare, takimet e kryetarit me drejtorët, mbikëqyrja e punës së kryetarit dhe pjesëmarrja e qytetarëve në vendimmarrje. Në dekadën e kaluar fokusi ndaj transparencës, si një aspekt i përmirësimit të qeverisjes dhe luftës kundër korrupsionit, ka qenë në nivel kombëtar, që lidhet kryesisht me prijet globale të pluralizmit, demokratizimit dhe përmirësimit të qeverisjes. Në një aspekt, kjo është e kuptueshme, pasi që korrupsioni - pasojë më e spikatur e mungesës së transparencës - shpesh është më i dukshëm në nivel kombëtar dhe për shkak se institucionet e legjislativit, ekzekutivit dhe gjyqësorit kanë qenë pikë tradicionale e referencës për luftimin e korrupsionit. Kohët e fundit, megjithatë, ekziston një ndryshim në drejtim të rritjes së transparencës në nivel lokal. Gjithnjë e më shumë po kuptohet rëndësia e ndërtimit të transparencës në nivel lokal si mjet për trajtimin e disa nga sfidave më të mëdha për zhvillimin e qëndrueshëm dhe demokracinë. Janë dy aspekte themelore të qeverisjes (dhe qeverisjes së mirë). Së pari, koncepti i qeverisjes është më i gjerë se qeveria.

Në kontekstin urban, kjo do të thotë se përgjegjësia për menaxhimin e çështjeve të një qytetit nuk është e kufizuar në pushtetin lokal, por përfshin një shumëllojshmëri të gjerë të palëve të interesuara, duke përfshirë: qeverinë qendrore dhe lokale, sektorin privat, organizatat e shoqërisë civile dhe ato të bazuara në komunitet, mediet, shoqatat profesionale dhe anëtarë të tjerë të shoqërisë civile. Së dyti, koncepti i qeverisjes fokusohet në institucionet dhe proceset. Në kontekstin e burimeve të pakta, që konkurrojnë, por të vlefshme, prioritetet duhet të vendosen me anë të proceseve që përfshijnë të gjitha palët e

interesuara në vendimmarrje. Kjo ka implikime të rëndësishme për zhvillimin e një kornize për promovimin e transparencës në nivel lokal.

Transparenca në proceset vendimmarrëse dhe në institucione ka potencial të bëhet një strategji qendrore për t'u angazhuar aktorët, luftën kundër korrupsionit dhe përmirësimin e cilësisë së qeverisjes urbane në përgjithësi. Prandaj, transparenca paraqet parimin thelbësor të qeverisjes së mirë. Qasja e lirë në informata luan një rol të rëndësishëm në promovimin e transparencës. Informacioni, megjithatë, duhet të jepet në kohë, të jetë relevant, i saktë dhe i plotë për t'u përdorur në mënyrë efektive. Çështjet se kush e prodhon atë informacion dhe për çfarë qëllimi, bëhen aspekte kyçe të transparencës, kur interesat konkurrense konvergojnë në një çështje të veçantë. Një nga modelet më të avancuara për sigurimin e transparencës është korniza pesë-pikëshe për rritjen e transparencës:

- *Vlerësim dhe monitorim,*
- *Qasje në informacion,*
- *Etikë dhe integritet,*
- *Reformë institucionale dhe*
- *Trajtimi i çështjeve specifike.*

Edhe pse kryetarët e komunave zgjidhen në mënyrë të drejtpërdrejt dhe se ky proces është demokratik, ky dokument vë në pikëpyetje nëse të njëjtit qeverisin në bazë të kësaj fryme. Në fakt, kryetarët janë shëndrruar në një autoritet dominues -me të gjitha kontradiktat që ky term nënkupton. Ata, pasi të zgjidhen, kanë tendencë të bëhen autoritet i dominimit në kuptimin që ata bëjnë përpjekje aktive për të përqendruar pushtetin në duart e tyre përmes një procesi politik që në fakt nuk është në linjë me vullnetin e popullit.

Burimet e këtij defekti demokratik janë të ndryshëm. Kjo është kryesisht një çështje që ndërlidhet me projektimin e mangët institucional që vepron si një pengesë për një sistem të balancuar të qeverisjes. Në veçanti, këto mangësi lidhen me mungesën e mekanizmave institucionalë që do të de-politizonin emërimin e drejtorëve komunalë dhe që do të siguronin fuqimisht funksionim të qeverisjes transparente dhe të përgjegjshme. Presheva nuk mund të vazhdojë më politikën e shumë partive që mbrojnë interesa të vogla duke e lënë qeverisjen e Luginës në dorë të qeverisë së Beogradit. Medvegja pasqyron sot atë çka ka ndodhur dhe po vijon të ndodhë në Luginë: Braktisja e interesave kombëtarë nga klasa politike shqiptare. Ndryshimet në tri komunat: Medvegjë, Bujanovc dhe Preshevë nuk janë një luks, as thjesht

dëshira individësh, por themelore dhe jetike për të shpëtuar Luginën. Për këtë, duhet së pari ta kthejmë vëmendjen në Medvegjë, pasi ka mbetur shumë e anashkaluar si në planin politik edhe në atë ekonomik dhe social. Jo se dy komunat e tjera shqiptare në Serbi janë më mirë, por Medvegja rënkon më shumë. Medvegja sot përbën rrezikun më të madh pasi popullsia shqiptare si pasojë e kushteve shumë të vështira ekonomike, politikave diskriminuese dhe pamundësisë për një jetesë normale ka emigruar me ritme të shpejta, duke e kthyer Medvegjinë në një zonë të braktisur. Nëse sot nuk ndërhyhet urgjentisht, ka rrezikshmëri të lartë që pas disa viteve aty të mos ketë më shqiptar, duke humbur kështu çdo gjurmë në atë trevë shqiptare të trashëguar nga të parët tanë. Dhe për këtë, fajtor do të jemi të gjithë ne, që e pamë, e lamë dhe nuk bëmë detyrën tonë kombëtare për të mbrojtur tokën dhe të ardhmen tonë. Të flasësh sot për bashkim në Luginë nuk është utopi, por domosdoshmëri dhe është mundësia e vetme për mbijetesë. Partitë politike që veprojnë në Luginën e Preshevës duhet të lënë mënjane interesat personale dhe duhet të bashkohen për të mbrojtur interesin kombëtar. Intelektualët shqiptarë në Luginë, duhet të ngrenë zërin e tyre për ndryshim, të bëhen prezent dhe të veprojnë në dobi të shqiptarëve të Luginës. Rinia ka nevojë për shpresë, për mbështetje, për nxitje për të ecur përpara. Ajo është ardhmëria jonë dhe të gjithë bashkë, duhet të punojmë që ta shpëtojmë rininë tonë, e cila duhet të bëhet pjesë e kësaj lufte, që nesër të marrë në dorë fatet e Luginës. Për këtë lind nevoja për unitet, për një besëlidhje mes shqiptarëve në Luginë, për bashkimin e të gjitha forcave politike, ekonomike, intelektuale dhe përparimtare në një institucion të vetëm, që të udhëheqë në mënyrë unike të gjitha zhvillimet në Luginën e Preshevës. Më shumë se kurrë ne kemi nevojë të jemi të gjithë bashkë, pa dallime bindjesh politike, statusi social dhe gjendjeje ekonomike.

Rikthimi i vëmendjes kombëtare në Luginë do të zgjojë edhe më shumë interesin dhe vëmendjen e ndërkombëtarëve, në mënyrë që edhe prezenca dhe ndihma e tyre të jetë sa më konkrete në Luginë. Tashmë të tria komunat, duhen parë si një njësi e tërë dhe jo të ndara. Kjo do të mundësojë përmirësim e gjendjes në Luginë.³⁹

³⁹ <https://presheva.com/>

7. Donacionet nga OJQ- ët (UNDP, USAID)

UNDP mbështet Serbinë në përpjekjet e saj për të arritur nivelin më të lartë të prosperitetit dhe dinjitetit njerëzor për të gjithë qytetarët e saj, pavarësisht nga gjinia, përkatësia etnike apo besimi i tyre. UNDP promovon zhvillimin e qëndrueshëm njerëzor, sigurinë njerëzore dhe mundësitë e barabarta për të gjithë, duke ofruar çdo mbështetje në dispozicion të Serbisë në progresin e saj drejt anëtarësimit në Bashkimin Evropian. Raporti vjetor i zhvillimit njerëzor, i porositur nga UNDP, fokuson debatin global mbi çështjet kyçe të zhvillimit, duke ofruar mjete të reja matëse, analiza inovative dhe propozime shpesh të diskutueshme politike. Korniza analitike dhe qasja gjithëpërfshirëse e Raportit Global mbartin në Raportet Rajonale, Kombëtare dhe Lokale të Zhvillimit Njerëzor, të mbështetura gjithashtu nga UNDP. Zhdukja e varfërisë në të gjitha format e saj mbetet një nga sfidat më të mëdha me të cilat ballafaqohet njerëzimi. Ndërsa numri i njerëzve që jetojnë në varfëri të skajshme ka rënë me më shumë se gjysmën midis viteve 1990 dhe 2015 - nga 1.9 miliardë në 836 milionë - shumë njerëz ende po luftojnë për nevojat më themelore të njeriut. Globalisht më shumë se 800 milionë banorë, ende jetojnë me 1.25 dollar të ardhura ditore, ku shumicës i mungon qasja në ushqim, ujë të pijshëm dhe kanalizime.

UNDP ndihmon Serbinë për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm që çon në ndryshime transformuese, duke sjellë përmirësime reale në jetën e njerëzve. Promovojnë një qasje të integruar për të arritur një zhvillim të qëndrueshëm duke trajtuar çështjet e ndërlidhura të qëndrueshmërisë shumëdimensionale dhe varfërisë, pabarazisë dhe përjashtimit, duke rritur njohuritë, shkathtësitë dhe teknologjitë e prodhimit për të zvogëluar rreziqet dhe për të mbajtur fitimet e zhvillimit. Ndihmojnë Serbinë për të ndërtuar kapacitetet e saj për të integruar konsideratat mjedisore në planet dhe strategjitë e zhvillimit, duke përfshirë menaxhimin dhe përdorimin e qëndrueshëm të burimeve natyrore; duke siguruar që pasuria natyrore përdoret për të përmirësuar jetën e njerëzve; nxitjen e rritjes ekonomike dhe të mjeteve të jetesës, dhe politikat më të mira të synimeve dhe mbrojtjes sociale për ata në nevojë. UNDP po promovon rritjen e qëndrueshme ekonomike, punësimin gjithëpërfshirës, barazinë gjinore dhe përmirësimin e qasjes në shërbimet sociale. Aktivitetet programatike kontribuojnë në disponueshmërinë dhe cilësinë e mundësive dhe shërbimeve të punësimit për njerëzit e përjashtuar dhe të prekshëm nga shoqëria. Këto aktivitete përfshijnë masat aktive të tregut të punës që i pajisin punëtorët për punësim në një ekonomi të bazuar në dije dhe që

kultivojnë kërkesën për punë, veçanërisht gratë, të rinjtë, personat me aftësi të kufizuara dhe pakicat. Mbështetja për krijimin e vendeve të punës të udhëhequr nga sektori privat në sektorët e shërbimeve, bujqësisë dhe prodhimit synon të reduktojë pabarazitë në të ardhurat urbane dhe rurale nëpërmjet iniciativave të bazuara në zona që synojnë rajonet e izoluara dhe të pafavorizuara. Kriza ekonomike ka vazhduar të ketë ndikim të konsiderueshëm në tregun e punës. Rritja ekonomike negative nuk ka qenë e favorshme për krijimin e vendeve të punës me norma të punësimit që ranë më tej në nivelin e tyre më të ulët në një dekadë. Papunësia arriti në 28% sipas të dhënave nga Dhoma e Tregtisë dhe është kryesisht strukturore: Rreth $\frac{3}{4}$ e të gjithë të papunëve kanë qenë pa punë për më shumë se një vit. Edhe më shqetësuese është fakti që punësimi ra edhe në sektorët që kishin ritme pozitive rritjeje, duke nënkuptuar fitime në produktivitetin e punës dhe informalitetet në rritje.

Papunësia e të rinjve, duke arritur në 52% në vitin 2012, është ende dukshëm mbi nivelin mesatar. Serbia Jugore dhe Jugperëndimore janë rajonet më ekonomike dhe sociale të privuara nga Serbia, me pasojë e krijimit të migrimit intensiv. Rritja e numrit të aplikimeve të azilit të rrejtshëm në disa vende evropiane është raportuar gjatë vitit 2012, me qytetarët serbë që mbeten në mesin e kombësive më të renditura të azilantëve në BE.

Sipas Zyrës Federale Gjermane për Migracionin dhe Refugjatët, 2,673 qytetarë serbë, shumica e të cilëve thuhet se janë anëtarë të komunitetit rom, kanë kërkuar azil në Gjermani për herë të parë në vitin 2012. Në tetor, pas kërkesave nga Austria, Belgjika, Gjermania, Luksemburgu dhe Holanda, Këshilli i Ministrave të BE-së diskutuan masat për të adresuar shqetësimet rreth numrit të kërkesave për azil nga Serbia dhe shtetet e tjera të Ballkanit. Këshilli u ndal më pak nga heqja e marrëveshjeve të liberalizimit të vizave që nga viti 2009, por në fakt kërkoi nga Serbia dhe shtetet e tjera të vendosin masa shtesë për të parandaluar kërkuarët e mundshëm të azilit që të largohen nga vendi. Qeveria vazhdoi të zbatojë masa aktive për të rritur përfshirjen sociale të romëve dhe grupeve të tjerat anashvendosur. Kjo rezultoi në rritjen e regjistrimit të fëmijëve në romë, si dhe në rritjen e numrit të mësimdhënësve romë (170) dhe koordinatorëve të shëndetësisë romë (75). Me mbështetjen e OKB-së, 7% e romëve pa shtetësi të vendit morën kartat e identitetit për herë të parë, duke lehtësuar qasjen e tyre në punë, arsim dhe shërbime shëndetësore. Megjithatë, disponueshmëria e shërbimeve të bazuara në komunitet mbetet e kufizuar dhe romët janë të ekspozuar ndaj formave të shumta të përjashtimit. Shumica e romëve ende jetojnë në vendbanime joformale nën kushte sfiduese, me mungesë të dokumenteve personale dhe kështu qasjes në shërbimet publike dhe janë pra grupi më i diskriminuar në tregun e punës.

Gratë rome ballafaqohen me vështirësi të mëtejshme duke iu nënshtruar shpesh dhunës në familje. Të dhënat jozyrtare, të mbledhura përmes intervistave me gratë rome nga katër vendbanime joformale, tregojnë shkallë ekspozimi potencialisht të lartë të dhunës (90% - 100%). Në të njëjtën kohë, buxheti kombëtar për masat aktive të tregut të punës është ulur ndjeshëm nga 66 milionë euro në vitin 2011 në rreth. 30 milionë në vitin 2012 dhe 2013, gjë që sugjeron një përkeqësim të mëtejshëm të gjendjes mbizotëruese të romëve dhe grupeve të tjera të prekshme në të ardhmen e afërt. Dënimi publik i dhunës kundër grave, një fushë ku UNDP ka qenë aktive për disa vite, është rritur ndjeshëm në vitin 2012. Qeveria po tregon më shumë përkushtim në përgjithësi, por bashkëpunimi i institucioneve relevante me mandat për të ofruar mbrojtje, mbrojtje dhe mbështetje adekuate për viktimat e dhunës me bazë gjinore duhet të forcohet më tej. UNDP mbetet pozicionuar fuqimisht për të vazhduar mbështetjen e Qeverisë në çështjet gjinore, duke marrë parasysh ekspertizën e saj të dëshmuar dhe rezultatet e prekshme të arritura gjatë viteve të fundit.

Në fushën e përfshirjes sociale, UNDP kryesisht zbatoi programe gjithëpërfshirëse të zhvillimit. Nëpërmjet Fondit të Punësimit Rinor, UNDP ka mbështetur mbi 2800 të rinj të pafavorizuar për të marrë punësim, për trajnim profesional ose për të marrë grande për vetëpunësim. Rreth 10% e tyre ishin përfitues të mirëqenies sociale dhe me këtë masë kaluan nga mirëqenia në punë. Vlerësimi i ndikimit konfirmoi se 25% e të rinjve që kanë pësuar trajnime në vendin e punës janë punësuar më pas, 74% kanë arritur të mbajnë biznesin e tyre dhe 97% e PAK që kanë marrë subvencione për punësim kanë mbetur të punësuar. UNDP ka mbështetur krijimin e 5 Qendrave Këshillimore Qytetare për të zgjeruar shërbimet për të kthyerit nga Evropa Perëndimore. 70 administratorë komunalë janë trajnuar se si të lehtësojnë procesin e riintegrit të të kthyerve sipas marrëveshjeve të riprimit dhe më pas kanë ofruar 847 shërbime këshillimore. 725 individë romë morën kështu kartat e tyre të identitetit dhe dokumentet personale. 400 profesionistë të shëndetit u arsimuan mbi kulturën, dobësitë dhe të drejtat e romëve dhe Koordinatorët e Shëndetit të Romëve arritën në 5,000 familje të reja, gjë që rezultoi që 1,400 romë të paregjistruar që hynin në sistemin shëndetësor për herë të parë. UNDP ndihmoi Qeverinë të përshtatë më shumë politika të ndjeshme gjinore, të cilat kontribuan në rritjen e rasteve të raportuara të dhunës kundër grave. Vlera e shtuar e UNDP ishte gjithashtu e dukshme në mbështetje të Drejtorisë për Barazi Gjinore, e cila krijoi një sërë masash të reja të dhunës seksuale dhe gjinore, të përqendruara në 1) parandalimin (p.sh. miratimin e Strategjisë Kombëtare për Luftimin dhe Parandalimin e Dhunës ndaj Grave në Familje dhe në Marrëdhëniet e Partnerëve Intim); 2) mbrojtja (p.sh. linjat telefonike dhe

shtëpitë e sigurta); dhe 3) masa mbështetëse (zhvillimi i kapaciteteve të ofruesve të shërbimeve) për viktimat e dhunës në familje. Për të rritur shkallën e dhunës së raportuar, UNDP ka mbështetur krijimin e 4 linjave të reja të nxehta dhe 2 linjave të reja të nxehta për minoritetet etnike dhe gratë rome.

UNDP ka mbështetur Akademinë e Policisë, Akademinë e Gjyqësorit dhe Agjencinë e Burimeve Njerëzore të Qeverisë së Serbisë për të futur kurrikula të reja për dhunën ndaj grave dhe barazinë gjinore në programet e tyre të rregullta arsimore. Në vitin 2011, gjithsej 150 zyrtarë shtetërorë, 400 oficerë policie dhe 300 gjyqtarë dhe prokurorë u trajnuan se si të merren me viktimat e VAË pa i ekspozuar ndaj viktimizimit dytësor. UNDP kontribuoi në rritjen e ndërgjegjësimit për barazinë gjinore dhe VAË duke mbështetur botimin e 3762 artikujve për këto tema në vitet 2010-2011. Ndërsa mbulimi mjaft i gjerë është pozitiv, fakti që 80% e artikujve përkatës është publikuar në faqet e mbuluara të gazetave kombëtare tregon një tendencë drejt raportimit sensacional. Për të balancuar këtë UNDP ka trajnuar më shumë se 90 gazetarë dhe redaktorë për të marrë një pikëpamje më objektive mbi këtë temë. Rezultatet e arritura në këtë fushë u njohën në Raportin e Progresit të BE-së për vitin 2012.⁴⁰

7.1 Donacionet nga USAID dhe UNDP në Komunën e Preshevës

Përfaqësues nga Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Programi i Kombeve të Bashkuara për Zhvillim (UNDP) dhe Qeveria e Republikës së Serbisë në Preshevë kanë lëshuar në funksion rezervarin të ri me kapacitet prej 1000 metra kub ujë dhe rezervarin e rekonstruar prej 500 metra kub (në fund të vitit 2017)

USAID ka ndihmuar Preshevën gjithashtu për përmasimin e menaxhimit të mbeturinave, dhe në bashkëpunim me Ndërmarrjen Publike “Moravica” kanë siguruar 1000 kontejnerë për mbeturina në fshatin Miratoc (në vitin 2017).⁴¹

⁴⁰<http://www.rs.undp.org/content/serbia/sr/home/operations/undp-in-serbia.html>

⁴¹<https://www.usaid.gov/serbia/press-releases/dec-08-2017-usaid-and-serbian-government-inaugurate-new-and-reconstructed>

KAPITULLI I TRETË


Hulumtim empirik mbi mendimin e qytetarëve për pushtetin lokal në Komunën e Preshevës

Në këtë kapitull kam bërë një hulumtim empirik mbi mendimin e qytetarëve për pushtetin lokal në komunën e Preshevës, ku si metodë kam përdorur anketimin. Anketa është zhvilluar në qytetin e Preshevës, ku janë të përfshirë persona me shkollim të mesëm dhe të lartë të grup-moshave të ndryshme. Numri i të anketuarve është 180 vetë, prej të cilave 113 janë të gjinisë mashkullore kurse 67 janë të gjinisë femërore. Në anketë janë parashtruar gjithsej 15 pyetje me mundësi të ndryshme për tu përgjigjur, në mënyrë që të anketuarit të kenë sa më lehtë hapësirën për përgjigje dhe të mund të shprehin mendimin e tyre të lirë.

Në vazhdim do të paraqes çdo pyetje në përqindje me grafikon.

Grafikoni 1


Numri i përgjithshëm i të anketuarve është 180 respondentë. Meshkuj 113, ndërsa femra 67.



Në grafikonin e parë janë paraqitur në përqindje numrit të pjesëmarrësve në anketë në bazë të gjinisë së tyre duke dal në pah që 63% i të anketuarve janë meshkuj, kurse 37% janë femra.

Grafikoni 2


Grup mosha e të anketuarëve



Në grafikonin e dytë shihet qartë në përqindje mosha e pjesëmarrësve në anketë, këtu mund të dallojmë se përqindja më e madhe është nga mosha 31-40 vjeç, nga kjo kuptojmë se pjesëmarrësit e kësaj moshe janë më të informuar sa i përket pushtetit lokal në Luginën e Preshevës.

Grafikoni 3


Niveli i shkollimit



Nga grafikoni i tretë mund të kuptojmë se numri më i madh, 91 nga të anketuarit, janë me shkollim të mesëm. Pastaj janë niveli i dytë, 89 nga të anketuarit me shkollim të lartë, domethënë me përqindje pak më të vogël.

Grafikoni 4


Vendbanimi të anketuarve



Në këtë anketim jam munduar që t'i përfshi edhe popullatën e fshatrave të Preshevës, ku nga fshatrat i kam anketuar 130 persona, kurse nga qyteti i Preshevës i kam anketuar gjithsej 50 persona.

Grafikoni 5

Kur keni punë në komunë si i kryeni ato?



Për këtë pyetje me përgjigjen “shpejtë” janë përgjigjur 20 persona, me përgjigjen “presim shumë” janë përgjigjur 120 persona, kurse me përgjigjen “pritje të arsyeshme”

janë përgjigjur 40 persona. Sipas kësaj del se qytetarët në përgjithësi i marrin shërbimet nga Komuna duke mos pritur shumë.

Grafikoni 6


A mund të kryhen më shpejt punët në komunë?



Qytetarët nuk i kryejnë punët e tyre shpejtë në komunë. Këtë e deklaroi numri i përgjigjeve që kanë dhënë qytetarët e kësaj komune, ku 150 të anketuarve janë përgjigjur me përgjigjen “po” se punët që i kanë ata në komunë mund të kryhen edhe më shpejt, domethënë se organet e komunës së Preshevës mbas këtij fakti nuk funksionojnë si duhet.

Grafikoni 7


A e dini ju si mund të kryhen punët në Komunën e Preshevës?



Nga respondentët kemi marrë këto përgjigje, 52% deklarojnë se “po” dinë ti kryejnë punët në Komunën e Preshevës, 38% thonë se “jo”, kurse 10% prej tyre thonë se “nuk dinë” asnjë informatë se si t i realizojnë ato.

Grafikoni 8


Sa jeni të kënaqur nga shërbimet që ju ofron komuna?



Në këtë pyetje shihet se gjysma e të anketuarve u ndanë të kënaqur, pra 50 persona janë përgjigjur me përgjigjen “të kënaqur” ndërsa me përgjigjen “të pakënaqur” janë përgjigjur 38 persona dhe “të revoltuar” janë përgjigjur 10 persona, kjo bie direkt në kundërshtim me rezultatin e dhënë prej përgjigjeve nga pyetja më lart që ishte “A mund të kryhen punët më shpejtë në komunën e Preshevës” ku shumica thanë që “po” d.m.th organet e komunës së Preshevës nuk funksionojnë si duhet.

Grafikoni 9


Me cilin prej këtyre institucione keni më shumë kontakt?



Nga kjo pyetje 98 prej të anketuarve thanëse kanë kontakt më komunën, sipas kësaj komuna është sërish institucioni më së shumti që kontaktohet, kurse 55 prej të anketuarve kanë deklaruar për shtëpinë e shëndetit, 2 policinë, 15 shkollën, 5 askund, kurse 5 tjerë institucione.

Grafikoni 10

Ku bëhet më shumë padrejtësi?




Në këtë pyetje janë përgjigjur 39 nga të anketuarit për Shtëpinë e Shëndetit, 1 për policinë, 3 për shkollën, 7 askund, 10 për tjerë institucione dhe 120 për komunën nga ky grafikon kuptojmë se institucioni, i cili vizitohet më së shumti po në atë institucion bëhen më

shumë padrejtësi domethënë ai institucion është komuna, pastaj në polici, në shtëpinë e shëndetit etj.

Grafikoni 11

Si e vlerësoni punën e drejtuesve të pushtetit lokal në Komunën e Preshevës?



Në këtë grafikon shihet se gati gjysma e të anketuarve domethënë 102 persona kanë vlerësuar punën e drejtuesve të pushtetit lokal në Komunën e Preshevës me notë të dobët, 14 persona me notën 2, 19 persona me notën 3, 11 persona me notën 4 dhe 34 persona me notën 5. Nga kjo përqindje shihet se në përgjithësi qytetarët e Komunës së Preshevës nuk e pëlqejnë punën që e bëjnë drejtuesit e kësaj komune.

Grafikoni 12

Si e vlerësoni punën e Kryetarit të Komunës?



Gjithashtu, edhe në këtë grafik shihet pothuajse i njëjti vlerësim ashtu si në grafikun 12. Më pak se gjysma e të anketuarve kryetarit të Komunës së Preshevës i dhanë notë të mirë, kurse notë të dobët i dhanë 120 anketues.

Grafikoni 13


A keni informata të mjaftueshme për shërbimet dhe punët që kryhen në komunë?



Kësaj pyetje 152 anketues ju përgjigjen me përgjigjen “po” se kanë informata të mjaftueshme për shërbimet dhe punët që kryhen në komunë, kurse 28 anketues me përgjigjen “jo” se nuk kanë informata të mjaftueshme.

Grafikoni 14


Kur keni punë në Komunë a dini fillimisht ku të drejtoheni?



Në këtë grafik shihet se qytetarët e kësaj komune e njohin mirë komunën, ngase 163 anketues thanë “po” se din shumë mirë ku të drejtohen nëse kanë punë në komunë, kurse vetëm 17 anketues u përgjigjen me përgjigjen “jo”.

Grafikoni 15


A dini se në Komunën e Preshevës ekziston një qendër për informim të qytetarëve mbi punën e vetëqeverisjes lokale?



Në këtë grafik shihet se kësaj pyetje i janë përgjigjur 29 anketues me përgjigjen “po”, kurse 151 anketues me përgjigjen “jo” se nuk kanë informata rreth qendrës së informimit në Komunë e Preshevës, kjo i bie se qytetarët e kësaj komune nuk janë të interesuar aq shumë për punën e vetëqeverisjes lokale.

Grafikoni 16


Sa është publike puna e pushtetit lokal në komunën e Preshevës?



Nga ky grafikon shihet se kësaj pyetjeje i janë përgjigjur 47 anketues me përgjigjen “po”, 23 anketues me përgjigjen “jo”, 35 anketues me përgjigjen “fare pak” dhe 75 anketues me përgjigjen “aspak. Sipas qytetarëve del se komuna nuk është transparente për punën që bën, kurse nga pyetja më lart pamë se në komunën e Preshevës kishte një qendër për informim të qytetarëve mbi punën e vetëqeverisjes lokale, por ishin qytetarët ata që nuk kishin njohuri për këtë qendër, nga kjo gjithashtu del se vetë qytetarët nuk janë të interesuar të dinë se si funksionon komuna e tyre, ose nuk kanë qenë të sinqerte në përgjigjet e tyre.

Grafikoni 17

Për cilën çështje do të dëshironi që komuna të marrë pëlqimin tuaj për:



Nga ky grafikon shihet se përqindjet janë pothuajse të barabarta, nga se çështjet e komunës janë edhe çështje të cilat duhet ti takojnë edhe qytetarëve edhe ata duhet të marrin pjesë në vendime pasi vet kryetarin e komunës e zgjedh populli. Por 30% e të anketuarve kanë deklaruar se kanë diçka tjetër që duhet komuna t'i pyes (kryesisht për vendimet në shëndetësi) përqindje më të madhe ka përmirësimi i furnizimit me ujë dhe pastërtia e qytetit, por se a e marrin pëlqimin e qytetarëve për vendimet që marrin drejtuesit e kësaj komune mbetet të shihet në vazhdim.

Grafikoni 18


Ju personalisht sa keni mundësi ndikimi në punën e pushtetit lokal?



Në këtë pyetje janë përgjigjur 9% e anketuesve janë përgjigjur “shumë pak”, 10% me përgjigjen “pak”, 32% me përgjigjen “fare pak” kurse 49% e të anketuesve me përgjigjen “aspak” nga ky rezultat shihet se qytetarët e komunës së Preshevës nuk ndikojnë aq shumë në punën e pushtetit lokal, ata shfrytëzojnë vetëm të drejtën e zgjedhjes së udhëheqësit të komunës së Preshevës.

Grafikoni 19

Çka mund të ndikojë në përmirësimin e punës së pushtetit lokal në Komunën e Preshevës?



Në këtë pyetje janë përgjigjur 2% e anketuesve me përgjigjen “tjetër”, 22% me përgjigjen “zgjedhje të reja”, 32 % me përgjigjen “modernizimi i shërbimeve” kurse 32%

me përgjigjen “ndryshimet kadrovike” . Për ata që mendojnë se funksionimi jo i mirë i komunës së Preshevës vjen nga udhëheqësit jo të duhur të kësaj komune, mendojë që nuk kanë qenë të sigurtë ose kanë qenë jo simpatizant të partisë politike që është në pozitë, për arsye se realiteti është se të gjitha partitë politike që kanë qenë në pozitë nuk ka pasur asnjë ndryshim nga gjendja e mjerueshme dhe jo efektive e komunës së Preshevës në përgjithësi, por se problem kryesor mendojë edhe unë si shumica e qytetarëve është modernizimi i shërbimeve.

Grafikoni 20

A jeni ballafaquar me korrupsion kur keni pasur ndonjë punë në Komunën e Preshevës?



Në këtë grafik shihet se kësaj pyetje 3% e anketuesve janë përgjigjur me përgjigjen “asnjëherë”, 7% me përgjigjen jo, 38% me përgjigjen “ndonjëherë”, kurse 52% me përgjigjen “po” nga ky rezultat shihet qartë se korrupsioni është shumë i theksuar në këtë aspekt, qytetarët përdorin korrupsionin si mënyrë për ti marr shërbimet më lehtë nga komuna.

Çka mund të thoni diçka për shëndetin, infrastrukturën dhe arsimin në vendin tuaj?

Në këtë pyetje nuk janë përgjigjur të gjithë anketuesit, por ata të cilët janë përgjigjur janë pothuajse të mendimit të njëjtë, duke thënë se asgjë në këtë komunë nuk funksionon si duhet dhe se të gjithë drejtuesit e kësaj komune nuk janë aspak të përgjegjshëm për punën që bëjnë.

Anketa

Numri i të anketuarve është 180, prej të cilëve 113 janë të gjinisë mashkullore, kurse 67 janë të gjinisë femërore. Në anketë janë përshtatur gjithsej 15 pyetje me mundësi të ndryshme për të përgjigjur, në mënyrë që të anketuarit të kenë hapësirën për përgjigje dhe të mund të shprehin mendimin e tyre.

Anketa përmban këto të dhëna	Numri i përgjithshëm i të anketuarve 180 vetë
Gjinia	113 meshkuj, 67 femra
Grup-mosha	Nga 25 deri 55 vjet
Niveli i arsimit	Të mesëm dhe të lartë

Pyetjet e Anketës

Anketa i përmban këto pyetje:

1. Kur keni punë në komunë si i kryeni ato:
a) Shpejtë
b) Pritni shumë
c) Pritje e arsyeshme
2. A mund të kryhen më shpejt punët në komunë?
a) Po
b) Jo
c) Nuk e di
3. A dini qytetarët si mund të kryhen punët në Komunë e Preshevës?
a) Po
b) Jo
c) Nuk e di
4. Sa jeni të kënaqur nga shërbimet që ju ofron komuna?
a) Të kënaqur
b) Të pakënaqur
c) Nervoz të revoltuar
5. Me cilin prej këtyre institucione keni më shumë kontakt?
a) Me Shtëpinë e Shëndetit
b) Policinë

c) Komunën
d) Shkolla
e) Askund
f) Tjetër.
6. Ku bëhet më shumë padrejtësi?
a) Shkolla
b) Shtëpi të shëndetit
c) Komunë
d) Polici
e) Askund
7. Si e vlerësoni punën e drejtuesve të pushtetit lokal në Komunën e Preshevës?
a) 1
b) 2
c) 3
d) 4
e) 5
8. Si e vlerësoni punën e Kryetarit të Komunës?
a) 1
b) 2
c) 3
d) 4

e) 5
9. A keni informata të mjaftueshme për shërbimet dhe punët që kryhen në komunë?
a) Po
b) Jo
10. Kur keni punë në Komunë a dini fillimisht ku do të drejtoheni?
a) Po
b) Jo
11. A dini se në Komunën e Preshevës ekziston një qendër për informim të qytetarëve mbi punën e vetëqeverisjes lokale?
a) Po
b) Jo
12. Sa është publike puna e pushtetit lokal në Komunën e Preshevës?
a) Shumë
b) Pak
c) Fare pak
d) Aspak
13. Për cilën çështje do të dëshironi që Komuna të marrë pëlqimin tuaj për:
a) Infrastrukturë rrugore
b) Pastërtinë e qytetit
c) Përmirësimin e furnizimit me ujë
d) Për të gjitha

e) Diçka tjetër
14. Ju personalisht sa keni mundësi ndikimi në punën e pushtetit lokal?
a) Shumë pak
b) Pak
c) Fare pak
d) Aspak
15. Çka mund të ndikojë në përmirësimin e punës së pushtetit lokal në Komunën e Preshevës?
a) Ndryshimet kadrovike
b) Modernizimi i shërbimeve
c) Zgjedhjet e reja
d) Tjetër
16. A jeni ballafaquar me korrupsion kur keni pasur ndonjë punë në Komunën e Preshevës?
a) Po
b) Jo
c) Ndonjëherë
d) Asnjëherë
17. Çka mund të thoni diçka për shëndetin, infrastrukturën dhe arsimin në vendin tuaj?

KONKLUZIONE DHE REKOMANDIME

Pra, qeverisja lokale si disiplinë shkencorë shumëdisiplinare paraqitet me shumë tipare të veçanta që nga lindja dhe gjatë zhvillimit të saj. Lindja e qeverisjes lokale ndërlidhet me dukuritë e para të saj pavarësisht se ajo si disiplinë shkencore paraqitet shumë më vonë, kur merr tiparet e një discipline të pavarur nga disiplinat e tjera shkencore në kuadër të së cilave studiohej më parë dhe nga të cilat u shkëput në kushte dhe rrethana të reja të zhvillimit dhe të diferencimit të shkencës. Sipas shfletimit të literaturës vendase dhe asaj të huaj erdha në konkludim se fillimisht ajo është studiuar në kuadër të shkencave politike dhe të shkencave juridike. Secila disiplinë shkencore si dhe secila dukuri si fenomen shoqëror kushtëzohet në parim me lindjen dhe zhvillimin e vet nga rrethanat e caktuara shoqërore. Në literatur bëhet fjalë për disa parakushte që duhet të përmbushen kur është fjala në lidhje me shkencat shoqërore. Nuk ka dyshim se parakusht themelor i lidhjes së një discipline shkencore është vetë paraqitja e substratit të dukurisë shoqërore të caktuar. Njëjtë është edhe me qeverisjen lokale, të cilën e kemi vërejtur edhe në punimin tim të masterit.

Në bazë të anketës, të cilën e kemi realizuar, erdhëm në përfundim se Komuna e Preshevës është një komunë shumë e mbyllur. Qytetartë e komunë së Preshevës nuk janë aspak të kënaqur me funksionimin e saj, ata realisht nuk marrin pothuajse aspak pjesë në procesin e vendimmarrjes. Qytetarët dëshirojnë që nga ana e pushtetit lokal të marrin pëlqim për vendosmërinë mbi shëndetin, arsimin, infrastrukturën , të paktën në disa fusha më kryesore dhe më të rëndësishme për jetes. Po ashtu në përfundim kemi ardhur se edhe UNDP ka pasur një kontribut shumë të madh mbi pushtetin lokal të Komunës së Preshevës. Duke parë ngecjet dhe dinamikat e ulëta, pengesat me të cilat po përballlet qeverisja lokale, mungesën e një reforme serioze për t'i dhënë funksionalitet decentralizimit në komunë.

Rekomandime

Autoritetet komunale dhe në veçanti këshilltarët komunal, mund të gjejnë mënyra për të edukuar qytetarët mbi çështjet e qeverisjes lokale dhe për të motivuar më mirë ata të marrin pjesë në punën e pushtetit lokal. Egziston nevoja për një mekanizëm të institucionalizuar të auditimit për të vlerësuar performancën e qeverisë dhe cilësinë e ofrimit të shërbimeve publike duke përfshirë qytetarin. Shërbime dhe qeverisje e përmisuar lokale kërkon burime financiare dhe njerëzore. Këto burime mund të rriten në bashkëpunim me të

gjithë aktorët publik nëpërmjet participimit financiar, investimeve të reja qeveritare, vendosmëri më të madhe nga qeveria.

Qeveria lokale tashmë duhet të investojë në cilësinë e shërbimeve dhe jo vetëm në gjithëpërfshirjen e tyre. Komunitetet poasht duhet të punojnë të largohen nga dominanca politike për të punësuar njerëz më të aftë për sa i përket kualifikimit të tyre profesional, të cilët do të gjeneronin dhe përdornin në mënyrë më efektive burimet e ofrimit të shërbimeve lokale. Llogaridhënia dhe transparenca duhet të jenë gjuha e profesionalizimit të politikbërësve dhe zyrtarëve lokal.

Mbi të gjitha, komunitetet duhet të ketë një proces të konsoliduar lokal ku delegimi i kompetencave lokale shoqërohet me burime më të larta financiare. Kjo arrihet nëpërmjet një tresheje të fortë: Qytetarët, Komunitetet dhe Qeveria Qendrore. Secila palë në këtë treshe duhet të kuptojë përgjegjësitë dhe të drejtat e veta dhe të kërkojë hapësira të bashkëpunimit të ngushtë në mes veti për të krijuar energjinë e duhur drejt zgjidhjes së problemeve të qytetarëve në kohë dhe ofrimit të shërbimeve cilësore lokale.

Sipas logjikës së kahmotëshme të regjimit të Serbisë për “shqiptarët e ndershëm”: “Budi naš, radi kako znaš!” (“*Bëhu i yni dhe vepro si të duash!*”), është uzurpuar dhe masakruar skajshmërisht funksionimi i pushtetit lokal në komunitetin e Preshevës. Marrëdhëniet midis pushtetit qendror dhe atij vendor kanë qenë gjithmonë delikate. Transferimi që pushteti qendror i bën kompetencave të tij tek pushteti vendor, duhet të shihet si një e mirë e përgjithshme dhe jo si një detyrim për ta bërë këtë gjë. Një delegim i cunguar i kompetencave ose fiktiv, do të ishte në dëm të të gjithëve.

Marrëdhëniet midis pushtetit qendror dhe atij vendor, rregullohen nëpërmjet një kuadri ligjor që në përgjithësi është bashkëkohor, mbulon me përpikëri, pothuajse një pjesë të mirë të problemeve që mund të dalin në praktikë, por megjithatë ka akoma vend për përmirësime të mëtejshme. Këto nevoja për përmirësime të legjislacionit dolën qartë gjatë shqyrtimit dhe paraqitjes së çështjeve. Përmirësime të cilat, siç i paraqitëm edhe me sipër, në disa raste u reflektuan me ndryshime në legjislacionin mbi decentralizimin. Si përfundim, është shumë e rëndësishme të krijohet që në fillim, një skenar sa më i mirë dhe i mundshëm për t’u realizuar, sipas të cilit duhet të zbatohen reformat. Përveç forcimit të krijimit të kapaciteteve, përfshi reformimin e institucioneve dhe kualifikimin e personelit, në nivele vendore dhe caktimin e përgjegjësive, qeveria duhet të lehtësojë dhe të nxisë procesin e krijimit të stimuljeve për njësitë e pushtetit vendor për të bashkuar burimet e tyre dhe për t’i realizuar

bashkë shërbimet duke përfshirë edhe shkrirjen vullnetare, krijimin e shoqërive të përbashkëta dhe të marrëveshjeve të përbashkëta.

Raportet në mes Qeverisë Qendrore dhe Lokale: Komunat janë në mes të kërkesës së qytetarëve për shërbime dhe një ballafaqimi të vazhdueshëm me institucionet qendrore, ndërmarrjet regjionale dhe agjencitë qeveritare. Prandaj, është domosdoshmëri një intervenim direkt që do t'i ofronte qartësi të plotë rolit të komunave dhe institucioneve që operojnë në nivelin lokal, qoftë nëpërmes shërbimeve publike, administrative apo operacionale. Vlen të theksohet se dora e parë e shtetit është komuna dhe se shërbimi i parë i qeverisë vjen nëpërmes komunës. Arritjet të një shteti varen drejtpërdrejtë nga suksesi i komunës si institucion. Andaj, shteti është i fortë vetëm nëse komuna është e fortë. Komuna duhet të jetë një institucion i përgjegjshëm, efikas dhe funksional, në shërbim të forcimit të legjitimitetit, fuqizimit të demokracisë lokale, e që në esencë do të shërbente për një qeverisje llogaridhënëse dhe transparente që janë shtyllat e domosdoshme për një qeverisje të mirë. Janë një varg politikash, direktivash dhe shërbimesh që krijojnë dykuptimësi dhe ngecje të vazhdueshme për një qeverisje të decentralizuar funksionale. Andaj, pa një koordinim dhe bashkëpunim brenda institucional, me theks në mes të ekzekutivit dhe legjislativit, komunat rrezikojnë rrugëtimin e tyre drejt një qeverisje lokale efikase në shërbim të zhvillimit dhe mirëqenies së qytetarëve.

Tani më nuk kemi të bëjmë vetëm me aspektin politik, por e tërë fushëbeteja dhe fokusi kthehet në rrafshin e asaj se kush ofron shërbime më të mira. Është e domosdoshme që rruga e integritetit të vërtetë duhet të fillojë me veprime dhe arritje konkrete në teren. Në rast se ne nuk u ofrojmë shërbime kualitative, gjithëpërfshirëse të gjithë qytetarëve në secilën pjesë pa dallim, atëherë kemi lënë të hapur derën që të tjerët të ndërhyjnë dhe si pasojë të cenojmë në masë të madhe funksionalitetin e pushtetit lokal.

BIBLOGRAFIA

1. Aliu A. & Stavileci E. ;Qeverisja Lokale, njoftime themelore dhe shqyrtime krahasimtare, Tetovë – Prishtinë, 2009.
2. Koxhaj A.; Administrimi i sektorit publik, Tiranë, 2002
3. Aliu A.; Qeverisja lokale në Evropën Juglindore me vështrim në Republikën e Maqedonisë, Prishtinë, 2003
4. Bajrami A.; E drejta kushtetuese, Prishtinë, 1996
5. Aziri E.; Sociologjia, Tetovë, 2007.
6. Djordević J.; Politički sistem, Beograd, 1977.
7. Siljanovska – Davkova G.; "Komuna në mes normës dhe realitetit", Disertacion i mbrojtur në Fakultetin Juridik të Ljubljanes, 1993.
8. Handbuch der Kommunalen wissenschaft und Praxix, Berlin, 1956.
9. Trifunoski J. F; Moravica,Beograd, 1948.
10. Pavlović M. Šabić D.; Regionalni pristup i tipovi regionalne diferenciacije teritorije, Zbornik Radova, Geografski Institut "Jovan Cvijić", SANU, Beograd, 2006.
11. Stefan K.; Njohuritë themelore mbi pushtetet lokale në Sërbë, Budapest, 2014.
12. Zendeli F.; E drejta administrative, Shkup, 2014.
13. Osmani I.; Fillet e së Drejtës, Universiteti i Prishtinës, Fakulteti Juridik, Prishtinë, 2004.
14. Saliu K.; E drejta Kushtetuese I, botimi III, Tetovë,2002.

Dokumente Juridike

- Kushtetuta e R. se Serbise, Fletorja zyrtare e RS-së", nr. 72/09, 20/14 – Kushtetuta e Serbisë dhe 55/14),
- Ligji mbi qeverisjen lokale i R. se Serbise, Beograd. (*"Gazeta zyrtare e RS"*, nr. 129/2007 i 83/2014 – ligji tjetër)
- Statuti i Komunës së Preshevës
- Rregullorja e Kuvendit të Komunës së Preshevës
- Konventa Evropiane per Qeverisje Lokale,Strazburg, 1985 .

web-faqe

<http://www.presevo.rs/>

<https://en.wikipedia.org/wiki/Decentralization>

http://irek.ase.md/jspui/bitstream/123456789/131/1/Morozov-B_8-mai-2015.pdf-9.pdf

<http://www.mildredearner.org/restructuring/decentralization>

<http://documents.worldbank.org/curated/en/356911468766815123/pdf/19683010albani-an.pdf>

<http://www.rs.undp.org/content/serbia/sr/home/operations/undp-in-serbia.html>

<http://ina-online.net/hapja-e-shkolles-se-pare-shqipe-ne-presheve/>

<http://www.titulli.com/index.php?m=post&s=26243>

http://www.kt.gov.rs/images/prirucnik_2017alb.pdf

<http://lugina-lajm.com/2017/02/shtepia-e-shendetit-ne-presheve-fiton-donacion-prej-100-mije-eurove/>

http://www.southeast-europe.org/pdf/16/dke_16_ab_s_Fidan-Kosumi_%20Sfidat-ekonomike.pdf

<https://sq.wikipedia.org/wiki/Presheva>

[http://www.kosovapress.com/sq/opinione/ismajl-kurteshi-170/shqiptaret-e-lugines-se-presheves-jane-komuniteti-me-i-diskriminuar-ne-evrope-](http://www.kosovapress.com/sq/opinione/ismajl-kurteshi-170/shqiptaret-e-lugines-se-presheves-jane-komuniteti-me-i-diskriminuar-ne-evrope-38381/https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/02/Qeverisja-vendore-ne-Kosove.pdf)

[38381/https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/02/Qeverisja-vendore-ne-Kosove.pdf](https://shtetiweb.org/wp-content/uploads/2014/02/Qeverisja-vendore-ne-Kosove.pdf)